



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

# SHKUPË

| Numër 27 | Viti V | nëntor 2012 |

Numër  
falas



**4** VJET  
PËR  
**SHKUPIN**  
2009 - 2013





## Koce Trajanovski, Kryetar i Qytetit të Shkupit



### Të nderuar bashkëqytetarë,

Duke u nisur nga pamja e Shkupit me rrugë automobilistike të gjera dhe të sigurta, sipërfaqe të gjelbra të rregulluara dhe jetë më me kualitet për Ju, bashkëqytetarë të mi, Qyteti i Shkupit dhe unë si kryetar i tij në katër vitet e kaluara realizuam mbi 500 projekte të suksesshme të cilët zgjidhën përgjithmonë problemet e shumta shumëvjeçare nga jeta urbane dhe ndryshuan pamjen e Shkupit. Këto muaj të ardhshëm kalojnë katër vjet nga ardhja ime në funksionin Kryetar i Qytetit të Shkupit dhe mendoj se është koha e vërtetë në këtë bilanc të përmbledh çfarë kemi punuar dhe sa unë, dhe ekipi im kemi kontribuar që Shkupi të justifikojë vendin primar si metropol i Maqedonisë.

Në fillim dua të theksoj se më shumë përpjekje bëme për zgjidhjen e kaosit në qarkullimin rrugor dhe ngritjen e nivelit të higjienës publike — dy prioritete që i vendosa edhe në programin tim parazgjedhor para katër vjetësh, dhe për të cilin Ju, të nderuar bashkëqytetarë, më dhatë besimin Tuaj. Këtu do të theksoj se në katër vite e kaluara depërtuam dhe ndërtuam 15 100 metra rrugë të reja dhe bulevardë. Nuk mund të lë pa përmendur bulevardin "Ilinden" zgjerimi i të cilit kontriboi për transformimin e plotë nga një rrugë e ngushtë dhe jofunksionale në një bulevard

të vërtetë qarkullues, me trotuare të rregulluara, korsi për biçikleta dhe shumë gjelbërim. Ky projekt vërtetoi qëllimin tonë që të mos heqim dorë edhe para projekteve më të ndërlikuara ndërtimore. Kështu, Shkupi u bë me bulevardë të zgjeruara "Serbia", "Sveti Kliment Ohridski" dhe "Makedonska vojska", si dhe bulevardin "Boris Trajkovski".

Ndërtimi i unazës së parë në rrugën "Gjorçe Petrov", në komunën me të njëjtin emër, paralajmëroi ndërtimin e unazave në Shkup si zgjidhje ideale për zvogëlimin e kaosit në kryqëzimet me frekuencë të madhe dhe për rritjen e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor. Pas ndërtimit të unazave tek Kisha „Shën. Petar dhe Pavle“, në rrugën "Boca Ivanova" dhe në rrugën "Llazo Trpovski", kurorë e vërtetë e këtij tipi zgjidhjes të qarkullimit rrugor është unaza turbo rrethore që ndërtuam në bulevardin e zgjeruar "Mitropolit Teodosij Gologanov". Me realizimin e projekteve kapitale të tilla Qyteti i Shkupit imponoi standarde më të larta në ndërtim dhe falë përkrahjes Tuaj, të nderuar bashkëqytetarë, tregoi se me projekte me kualitet të lartë gjërat me të vërtetë mund të lëvizin nga më e mira.

Ekipet e Qytetit të Shkupit në katër vitet e fundit rinovuan 22 000 metra rrugë automobilistike. "Jane Sandanski", "Partizanski odredi", Kuz-

man Josifovski Pitu" dhe "Filip vtori makedonski", rrugët "Kemal Sejfulla", "Ferid Bajram", "Kozle", "Radishanska", Pere Toshev", Pelagonia", "Blagoja Stefkovski", "Ivan Kozarov" dhe shumë rrugë të tjera.

Paralelisht me depërtimin e rrugëve të reja automobilistike dhe me rinovimin e rrugëve të vjetra, përmirësuar rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe kanalizimin atmosferik dhe të ujërave të zeza. Me ndërtimin e kolektorëve për lagjet Lisiçe dhe Inxhikovë 130 000 qytetarë u lidhën me rrjetin e kanalizimit të qytetit dhe u dhanë lamtumirën gropave septike dhe problemeve shumëvjeçare.

Përgjatë rrugës magjistrale Shkup-Katlanovë, në bulevardin "Nikolla Karev" dhe në rrugën "Skupi" për herë të parë ndërtuam trotuar. Në aksionin e madh rinovuam trotualet dhe korsi-të e këmbësorëve përgjatë gjashtë kryqëzimeve kryesore në qendrën e qytetit, gjë me të cilën përmirësuar kushtet për lëvizjen e këmbësorëve.

Mbi lumin Vardar në Saraj u ngrit urë e re, kurse urë të re do të ndërtohet edhe në lumin Serava, në derdhjen e lumit Vardar.

Për zgjidhjen e problemeve me mungesën e vendeve për parkim në qytet për herë të parë vendosëm parkimin zonal dhe hapëm 1



**„SHKUP“**

LAJMËTARI INFORMATIV I  
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ

„Shkupi“ u botua më:

10 dhjetor 2008

**Kryeredaktor**  
Nedelčo Krstevski

**Redaksia**  
Seksioni për marrëdhënie me  
opinionin

**Redaktor i fotografi së**  
Radomir Jovanoviç

**Përkthyes dhe lektor**  
Vladimir Bogdanovski

**OTON QYTETI I SHKUPIT**  
**për botuesin**  
**Kryetari i Qytetit**  
**Koce Trajanovski**

Bulevardi Ilindenska p.n.

**Telefon**

02 3297 255

**e-mail adresa**

gragjani@skopje.gov.mk

**Dizajni/Botol:**

Graficki Centar Skopje

500 vende parkimi të reja. Garazhet me kate që ndërtohen në rrugën “Sveti Kiril i Metodij” dhe në rrugën “Dame Gruev” do të sigurojnë 1 000 vende parkimi plotësuese ose gjithsej 2 500 vende parkimi të reja.

Përveç zgjidhjes së problemeve të qarkullimit rrugor në qytet katër vitet e kaluara punuam edhe në ngritjen e nivelit të higjienës publike në Shkup dhe gjelbërimin e Qytetit. Kjo nënkupton rilindjen e ndërmarrjeve publike në të cilat nuk ishte investuar vite me radhë. Në fillim të mandatit tim NP „Higjiena komunale” dispononte vetëm me 6 automjete të vjetra të cilët shërbenin në të gjithë qytetin. Në katër vitet e fundit blemë 57 kamionë dhe automjete të reja për ngritjen e mbeturinave. Ndërmarrjen publike „Parqe dhe gjelbërim” e rinovuam me 40-të makina dhe automjete, makina të reja dhe bazë asfalti mori NP „Rrugë dhe rrugica”, investuam në depon „Drisla”, kurse blemë edhe pajisje të reja për Brigadën për mbrojtjen kundër zjarreve. Përkrahja shumë e madhe nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për të gjitha projektet e qytetit shikohet nëpërmjet projektit për rinovimin e parkut të automjeteve të NQP „Shkup” dhe blerjes së 216 autobusëve të rinj, me dysheme të ulët dhe dykatësh të cilët qarkullojnë nëpër rrugët e qytetit.

Dua të falënderoj Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për përkrahjen shumë të madhe dhe pa rezerva për të gjitha projektet e qytetit. Do të theksoj bashkëpunimin për depërtimin dhe zgjerimin e bulevardëve kryesore në qytet, bashkëpunimin në ndërtimin e rrugës automobilistike nëntokësore nën bregun e lumit Vardar, projektin për rinovimin e parkut të automjeteve të NQP „Shkup” dhe ndërtimin e teleferikut në Vodno. Do të përmend edhe përkrahjen financiare dhe logjistikën nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen e një numri të madh projektesh infrastrukturore që ishin të domosdoshme për përmirësimin e jetës të më shumë se qindra qytetarëve të Shkupit, dhe atë për ndërtimin e rrjeteve të ujësjellësit, të ujërave të zeza për Shuto Orizare, për Kamnik, për Lisiçë, Inxhikovë dhe për pjesë të tjera të qytetit në të cilat nuk ishte investuar vite të tëra.

Në sipërfaqet e gjelbra publike në qytet në aksione të rregullta mbollëm 46 253 fidanë gjetherënës, halor dhe kaçube, si dhe një milion lule. Rinovuam drurët përgjatë bulevardëve,

gjelbëruam zhardinierët e mesëm, dhe u ndamë 10 000 drurë falas këshillave banesor dhe institucioneve publike. Parku i qytetit mori një pamje krejtësisht të re, me gjelbërim të ri dhe përmbytje të reja interesante, dhe investuam në ngritjen e sipërfaqeve të reja të gjelbra dhe pajisje urbane edhe në park-pyllin “Vodno” dhe “Gazi Baba”.

Kopshti zoologjik pas 40 vjetësh u bë me gjirafë të re. U ndërtuan 40 vendbanime të reja dhe rinovuam një numër të madh të atyre ekzistuese. Me investimin direkt të Qytetit të Shkupit dhe me donacionin nga partnerët tanë Kopshti zoologjik u bë një kat modern për qëndrimin e kafshëve sipas të gjitha standardeve botërore dhe një vend i shkëlqyer për edukimin e më të rinjve.

Qyteti i Shkupit shpenzoi 85 milion denarë për rikonstruksionin e godinave të shkollave të mesme, gjithsej 21 shkolla, për të përmirësuar kushtet për punë të nxënësve dhe të të punësuarve. Në një pjesë të shkollave u rinovuan nyjat sanitare, sipërfaqet e mureve dhe dyshemeve, në një pjesë tjetër u zëvendësua zdrukthëtaria dhe çatitë e vjetra prej azbesti, në disa shkolla instalimet elektrike, kurse në disa shkolla të tjera është përfunduar rikonstruksioni i sallave sportive.

Blemë tre automjete për nevojat e personave me invaliditet të rëndë. Për Seksionin për nefrologji pranë Spitalit të përgjithshëm të qytetit „8. Shtatori” dhe Institucionin shëndetësor publik „Hekurana”, së bashku me komunën Qendër, dhuruam 2 aparate për dializë për pacientët me sëmundje të veshkave, kurse në SHMQSH „Mihajlo Pupin” vendosëm edhe platformë ashensori e cila është destinuar për persona të cilët lëvizin me ndihmën e karrocës për invalidë. Bashkëqytetarët tanë më të moshuar kanë mundësinë të udhëtojnë falas në autobusët e NQP —së të martën, të premten dhe të shtunën.

Qyteti i Shkupit organizoi dhe përkrahu nga ana financiare manifestime të shumta kulturore-zbavitëse që janë pjesë e identitetit të Shkupit dhe të cilat nga viti në vit tërheqin vëmendjen gjithnjë e më të madhe nga publiku. Do të përmend këtu “Vera e Shkupit”, “Teatri i ri i hapur”, “Cinedays”, “Nata e bardhë”, “Pivolend” dhe “Vinoskop”, “Baskerfest” dhe shumë e shumë të tjera. Rinovuam edhe objektet e Qendrës kulturore rinore, të Qendrës kulturore të fëmijëve „Karposh” dhe Sallonin 19,19. Përkrahëm edhe shumë manifestime sportive dhe nxitëm qytetarët të prak-

tikojnë veti të shëndetshme jetese dhe të merren me sport.

Në drejtim të zhvillimit dhe përmirësimit të jetës urbane në Shkup përgatitëm një varg studimesh që evidentuan problemet urbane dhe na dhanë drejtimet e vërteta në të cilat duhet të lëvizim. Janë përgatitur studime për vendosjen e tramvajit në Shkup, për ndërtimin e korsive për ski në Vodno, për modelin e qarkullimit rrugor në qytet, për partneritetin publik-privat për ndërtimin e „Luna-Park” etj.

Takimet e drejtpërdrejta me Ju, të nderuar bashkëqytetarë, ishin të një rëndësie të veçantë për punën tonë. Këmbyem ide, dhe pranuar kritikën Tuaja dhe i përmirësuar projektet. Për Shkupin tonë.

Unë zakonisht them — Ne nuk do të ndalemi këtu. Tani sërish do të theksoj se me të vërtetë nuk do të ndalemi në qëllimin tonë që Shkupi të bëhet një vend më i këndshëm për jetesë, qytet në të cilin respektohet rregulli dhe zgjidhen me nikoqirllëk problemet e grumbulluara.

## PËRMBAJTJA

|                                                                |     |
|----------------------------------------------------------------|-----|
| Ofensivë ndërtimore                                            | 1   |
| Vende të reja parkimi                                          | 58  |
| Rrjete të reja ujësjellësi                                     | 64  |
| Ndërtime plotësuese të kanalizimit atmosferik                  | 66  |
| Përmirësimi i kanalizimit të ujërave të zeza                   | 68  |
| Për siguri më të madhe në qarkullimin rrugor                   | 70  |
| Ndërmarrje publike të qytetit                                  | 74  |
| Sipërfaqe të reja të gjelbra dhe kujdesi për ambientin jetësor | 86  |
| Sport dhe rekreacion                                           | 104 |
| Mbrojtja sociale, e fëmijëve dhe shëndetësore                  | 108 |
| Projekte të realizuara në arsim                                | 112 |
| Bashkëpunimi ndërkombëtar                                      | 116 |
| Këshilli i Qytetit të Shkupit                                  | 118 |
| Kulturë dhe zbavitje                                           | 120 |

PASTAJ



# RRUGA “PRVOMAJSKA” U TRANSFORMUA NË BULEVARD “BORIS TRAJKOVSKI”

MË PARË



Qyteti i Shkupit realizoi me sukses projektin për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e bulevardit “Boris Trajkovski” (rruga e mëparshme “Prvomajska”), në komunën Kisela Voda. Kjo grykë e ngushtë e qarkullimit rrugor u shndërrua në një rrugë automobilistike të gjerë dhe qarkulluese, me katër korsi rrugore, trotuare të rregulluara, gjelbërim dhe me ndriçim të ri.

Bulevardi “Boris Trajkovski” është një nga arteriet më të mëdha dhe më të rëndësishme të qarkullimit rrugor në Shkup nga i cili varen direkt mbi 150 000 banorë të qytetit tonë. Në projektin voluminoz për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e bulevardit “Boris Trajkovski” punuam me vetëmohim 2,5 vjet. Me përfundimit të tij, mbeten në të kaluarën radhët e gjatë të automjeteve, kaosi dhe lëvizja e rënduar që tani janë pamje e përditshme në këtë rrugë. Bulevar-





di "Boris Trajkovski" me gjatësi 2,5 kilometra u transformua në një bulevard të gjerë dhe qarkullues, me trotuare të rregulluara dhe me gjelbërim anësor dhe vërtetoi përpjekjet e Qytetit të Shkupit për zgjidhjen e problemit me kaosin në qarkullimin rrugor dhe, që është akoma më e rëndësishme, për rritjen e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor – sqaroi kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Me këtë projekt u bë rikonstruksioni

i dy pjesëve të rrugës "Prvomajska" si vijon:

**Pjesa 1:** Drejtimi nga „Rampa“ deri në kryqëzimin me rrugën "Narodni heroj" me gjatësi 1 380 metra dhe

**Pjesa 2:** Drejtimi nga kryqëzimi me bulevardin "Serbia" deri në hyrjen e fabrikës së mëparshme të qelqit „Staklarnica“ me gjatësi 1 126 metra.

Gjatë punëve ndërtimore në të dy pjesët e bulevardit "Boris Trajkovski" u vendos kanalizimi atmosferik me profil të ndry-

shueshëm. Ura ekzistuese prej betoni të armuar u rinovua, zgjerua dhe ka 4 korsi rru-gore me korsi për këmbësorë dhe biçikleta.

Në projektin për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Boris Trajkovski", Qyteti i Shkupit investoi rreth 4 milion euro, para të siguruar nga Banka evropiane për rinovim dhe zhvillim, si kredi, dhe nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.

## U RINOVUA PJESA E URËS NË MARKOVA REKA DERI NË FABRIKËN „OHIS“



Në drejtimin nga Markova reka deri në fabrikën „OHIS“ rruga automobilistike në bulevardin "Boris Trajkovski" në vitin 2010 u riparua në gjatësi 2,5 kilometra. Për këtë punë të rëndësishme ndërtimore Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 14,5 milion denarë.

Rruga automobilistike në bulevardin "Boris Trajkovski" në këtë pjesë ishte shumë e dëmtuar. Me rikonstruksionin, rruga automobilistike u zgjerua 7 metra. Sipërfaqja është asfaltuar, dhe është shënuar sinjalizimi rrugor horizontal.

PASTAJ



## BULEVARDI "ILINDEN" MORI PAMJE TË RE

Në punët përgatitore për ndërtimin e bulevardit është ndërtuar kanalizimi atmosferik me profil të ndryshueshëm nga 400 deri në 1 000 milimetra. Përgjatë pjesës së zgjeruar nga të dyja anët janë vendosur 60 puseta dhe 105 vend derdhje për ujin

Zgjerimi dhe rikonstrukcioni i rrugës "Ilindenska" është një nga projektet më të mëdha të realizuara në territorin e qendrës së qytetit në 12 vitet e fundit. Rruga "Ilinden" u transformua në bulevard "Ilinden" në drejtimin nga kryqëzimi me bulevardin "Sveti Kliment Ohridski" deri te rruga "Lubjanska", me gjatësi 3 820 metra. Bulevardi u bë me dy korsi rrugore në çdo drejtim, trotuare të rregulluara dhe korsi për biçikleta, kryqëzime të reja, gjelbërim të mesëm dhe ndriçim të ri kursyes.

Në vitin 2010 u zgjerua pjesa e parë e bulevardit "Ilinden", nga kryqëzimi me bulevardin "Sveti Kliment Ohridski" deri te kryqëzimi me bulevardin "8. Septemvri", në gjatësi prej 2 140 metrash.

MË PARË





atmosferik. Për realizimin e këtij projekti të ndërlikuar Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 3,3 milion euro.

Në vitin 2011 u depërtua pjesa e dytë e bulevardit "Ilinden", nga kryqëzimi me bulevardin "8. Septemvri" deri te pompa e benzinës „Makpetrol“, me gjatësi 280 metra. Zgjerimi i kësaj pjesë të bulevardit "Ilinden" zvogëloi kaosin që krijohet në kryqëzimin me rrugën "Bledski dogovor", dhe u realizua edhe koordinimi i semaforëve në kryqëzimin me bulevardin "8. Septemvri". Në realizimin e kësaj pjesë të projektit Qyteti i Shkupit investoi rreth 20 milion de-



narë.

Këtë vit bulevardi "Ilinden" u zgjerua nga pompa e benzinës „Makpetrol“ deri te rruga "Lubjanska" me gjatësi 1 400 metra. Edhe në këtë pjesë bulevardi ka katër korsi rrugore. Bordurat përgjatë rrugës automobilistike janë

zëvendësuar plotësisht, dhe janë formuar trotuare të reja me gjerësi 2,5 metra. Ndërtimi i rrugës së re automobilistike u shfrytëzua për ndërtimin e kanalizimit të ri atmosferik me puseta dhe vend derdhje të reja.

Për këtë fazë të tretë, të projektit voluminoz për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e bulevardit "Ilinden" Qyteti i Shkupit investoi rreth 64 milion denarë.





# “MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV”

## U TRANSFORMUA NË BULEVARD TË GJERË ME KRYQËZIM TURBO RRETHOR



Kryqëzim turbo rrethor, rrugë automobilistike e zgjeruar me 4 korsi, trotuare të rregulluara, gjelbërim i ri i ngritur dhe ndriçim rrugor kursyes janë karakteristikat kryesore të bulevardit të rinovuar “Mitropolit Teodosij Gologanov” që ekipet e Qytetit të Shkupit e ndërtuan në dy faza. Zgjerimi i bulevardit u realizua në sipërfaqe të përgjithshme 2 700 metra dhe në një masë të madhe zgjidhi problemet e qarkullimit rrugor në territorin e qendrës së qytetit.

Në fazën e parë të punëve ndërtimore zgjerimi i rrugës automobilistike ekzistuese u realizua në drejtimin nga rruga “Franklin Ruzvelt” deri në rrugën

“Kosturski heroj” (një degë) dhe nga rruga “Sveti Kiril i Metodij” deri në kthesën në të djathtë drejt rrugës “Naroden front” (pjesa e dytë), me gjatësi të përgjithshme 1 600 metra. Kryqëzimi turbo rrethor i ndërtuar është i pari i këtij tipi në Shkup. Dy kryqëzimet e reja të semaforizuara, në rrugën “9. Maj” dhe në kthesën drejt rrugës “Naroden front” rregullojnë qarkullimin e automjeteve në unazë. Rreth unazës është vendosur rrethim mbrojtës metalik me gjatësi 280 metra që garanton sigurinë e këmbësorëve. Ujërat atmosferike nga rruga e re e zgjeruar derdhen në kanalizimin atmosferik ekzistues i cili është rinovuar. Përgjatë bulevar-

dit të zgjeruar janë mbjellur 100 drurë. Për këtë projekt Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 96 milion denarë.

Pjesa e dytë e rrugës “Mitropolit Teodosij Gologanov” është zgjeruar nga kryqëzimi me rrugën “Franklin Ruzvelt” deri në kryqëzimin me rrugën “Bradfordska” dhe bulevardin “8. Septemvri”. Gjatësia e kësaj pjese është 1 100 metra. Gjatë rinovimit të rrugës u krye zëvendësimi i bordurave, si dhe mbrojtja e instalimeve nëntokësore (instalimet e ujësllësit Ø 400 me gjatësi 400 metra dhe gazsllësit Ø 400 me gjatësi 420 metra). Zgjerimi i rrugës automobilistike është shfrytëzuar për të ndërtuar kana-



lizimin atmosferik me profil 200 dhe 400 milimetra i cili është lidhur me kolektorin ekzistues. Është kryer edhe rikonstruksioni i

kanalizimit ekzistues të ujërave të zeza nën bulevard me gjatësi 20 metra.

Qyteti i Shkupit në këtë punë volu-

minoze investoi rreth 47 milion denarë.



## PËRGJATË BULEVARDIT "MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV"

# PARK I RI ME SIPËRFAQË 30 000 METRA KATROR

Park me sipërfaqe 30 000 metra katror po rregullohet përgjatë bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov". Sipërfaqja e re gjelbër e rregulluar do të jetë një kat i këndshëm pushimi dhe rekreacioni për qytetarët.

Në këtë park do të formohet korsi këmbësorësh me gjatësi 700 metra që do të shtrohet me zhavorr të bardhë, dhe do të vendosen edhe rekuizite sportive të ngjashme me ato që Qyteti i Shkupit i vendosi në bregun e lumit Vardar. Në pjesën tjetër të parkut Qyteti i Shkupit do të rregullojë park për kanakarët dhe do t'u përgjigjet kërkesave të banorëve përreth që ruajnë kanakarë. Përgjatë parkut të bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov" do të vendosen çezma për ujë, stola dhe kosha për mbeturina. Në këtë sipërfaqe të gjelbër do të mbillen edhe 300 drurë.

Në rrugën "Bratfordska", Qyteti i Shkupit do të rinovojë çezmën e vjetër në stacionin hekurudhor, kurse ambienti përreth do të gjelbërohet dhe do të vendosen stola.





PASTAJ



## BULEVARDI "SVETI KLIMENT OHRIDSKI"

### U TRANSFORMUA NË NJË RRUGË AUTOMOBILISTIKE MODERNE

MË PARË



Nga kryqëzimi me rrugën "Sveti Kiril i Metodij" deri te kryqëzimi me rrugën "Dimitrija Tucoviq" me gjatësi 904 metra, bulevardi "Sveti. Kliment Ohridski" u bë me gjashtë korsi rrugore, trotuare të reja dhe korsi për biçikleta, ndriçim dhe gjelbërim të mesëm. Projektin voluminoz për zgjerimin dhe rikonstruksionin e kësaj rruge automobilistike Qyteti i Shkupit e realizoi në dy faza, kurse për punët ndërtimore shpenzoi gjithsej 67,5 milion denarë.

Në vitin 2011 u zgjerua pjesa e kryqëzimit me rrugën "Sveti Kiril i Metodij" deri në bulevardin "Partizanski odredi". Gjatë ndërtimit të kësaj pjese u rregulluan përsëri kryqëzimet ekzistuese, kurse në kryqëzimin me bulevardin "Partizanski odredi" u shkurtuan ishujt e këmbësorëve, gjë



me të cilën bulevardi "Partizanski odredi" u bë me tre korsi rrugore në drejtimin nga qendra e qytetit.

Gjatë punëve ndërtimore në këtë pjesë të bulevardit "Sveti Kliment Ohridski" instalimet nëntokësore ekzistuese u dislokuan nën trotuare. Tubi ekzistues i ujësjellësit ( $\Phi$  1 400 mm) është mbrojtur plotësisht me konstrukcion betoni të armuar. Për përcjelljen e ujërave atmosferik të rrugës së re automobilistike janë realizuar 42 vend derdhje plotësuese, dhe janë zëvendësuar kapakët e dëmtuar të 14 pu-setave të kanalizimit.

E rëndësishme është që përgjatë kësaj pjese të bulevardit "Sveti Kliment Ohridski" në disa vende ku trotuari është shumë i ngushtë dhe pothuajse i pakalueshëm tani ka një gjerësi të pranueshme prej 1,5 metrash.

Këtë vit, u zgjerua edhe pjesa nga kryqëzimi me bulevardin "Partizanski odredi" deri te rruga "Dimitrija Tucoviq". Gjatë ndërtimit të rrugës automobilistike të re, rrjeti ekzistues i kanalizimit u zëvendësua



plotësisht me të ri, me tuba hekuri të derdhur. Drejt rrjetit të ri të ujësjellësit janë përfshirë të gjithë shfrytëzuesit, gjë me të cilën është përmirësuar kualiteti i furnizimit me ujë të pijshëm në këtë pjesë të qytetit.

Në pjesën e mesme të bulevardit në këtë pjesë është ndërtuar zhardinier në të cilën është mbjellë bar, lule dhe 40 jarga-

vanë indian.

Me zgjerimin dhe rikonstrukcionin e bulevardit "Sveti. Kliment Ohridski" Qyteti i Shkupit hapi edhe një korridor të gjerë të qarkullimit rrugor në qendrën e qytetit, i cili lehtësoi në mënyrë të ndjeshme qarkullimin e automjeteve, zvogëloi kohën e udhëtimit dhe kaosin, dhe kontribuoi edhe për përmirësimin e kualitetit të ajrit.





# PESË KORSI PËR BULEVARDIN "SERBIA"

MË PARË



Në gjatësi prej 2 000 metrash bulevardi "Serbia" në vitin 2011 u bë me 5 korsi rrugore, trotuare të rregulluara dhe korsi për biçikleta, ndriçim të ri rrugor dhe gjelbërim të mesëm. Ky bulevard u zgjerua në pjesën e kryqëzimit me bulevardin "Vidoe Smilevski Bato" deri në bulevardin "Boris Trajkovski" (rruga e mëparshme "Prvomajska"). Në kryqëzimin me hyrjen e fabrikës „Usje“ është formuar unazë e cila mundëson qarkullimin rrugor pa ndërprerje.

Për ndërtimin e këtij objekti kapital Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth dy milion euro. Rruga e re automobilistike kontribuoi për komunikimin më të mirë ndërmjet komunave Aerodrom, Kisela Voda dhe Gazi Baba, për shkurtime të kohës së udhëtimit dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.

PASTAJ







## U PËRFUNDUA BULEVARDI “VIDOE SMILEVSKI BATO”

Në vitin 2009 u zgjerua bulevardi “Vidoe Smilevski Bato”, në lagjen Novo Lisiçe. Gjatësia e pjesës së zgjeruar është 510 metra, në drejtimin nga kryqëzimi me bulevardin “Serbia” deri në kryqëzimin “Fevruarski pohod”. Për punët ndërtimore u shpenzuan 30 milion denarë.

Bulevardi “Vidoe Smilevski Bato” me zgjerimin mori një pamje krejtësisht të re, me kanalizim atmosferik, llamba kur-syese, brez të gjelbër të mesëm dhe trotua-re të rregulluara.





PASTAJ



# U ZGJERUA RRUGA “MANAPO”

MË PARË



Rruga MANAPO, në drejtimin nga kryqëzimi me bulevardin “Partizanski odredi” deri në kryqëzimin me bulevardin “Ilinden” u bë me katër korsi rrugore, trotuare të reja dhe ndriçim rrugor. Ekipet e Qytetit të Shkupit këtë vit zgjeruan pjesë me gjatësi 500 metra.

Nga të dyja anët e rrugës së zgjeruar janë formuar trotuare të reja me gjerësi 3,5 metra dhe është vendosur ndriçim rrugor plotësisht i ri.

Ndërtimi i rrugës së re automobilistike në rrugën MANAPO u shfrytëzua për rikonstruksionin e plotë të kanalizimit të ujërave të zeza me gjatësi 640 metra dhe kanalizimit atmosferik me gjatësi 510 metra.

Realizimi me sukses i projektit për zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës MANAPO kontribuo i që të zgjidhen problemet shumëvjeçare që krijoheshin në këtë grykë të ngushtë të qarkullimit rrugor, kurse Shkupi u bë edhe me një rrugë të gjerë dhe qarkulluese që përbën një lidhje të mirë ndërmjet bulevardeve “Partizanski odredi” dhe “Ilinden”.

Në këtë punë ndërtimore Qyteti i Shkupit investoi rreth 28 milion denarë.



PASTAJ



## U DEPËRTUA PJESA E DYTË E BULEVARDIT “MAKEDONSKA VOJSKA”

Qyteti i Shkupit në vitin 2011 përfundoi me sukses ndërtimin e pjesës së dytë të bulevardit “Makedonska vojska” në komunën Gjorçe Petrov. Rruga e re automobilistike në drejtimin nga kryqëzimi me rrugën “Gjorçe Petrov” drejt stadiumit të KF „Makedonija Gjorçe Petrov”, me gjatësi 850 metra. Rruga e re automobilistike është e gjerë shtatë metra dhe ka nga një korsi rru-gore në çdo drejtim. Është asfaltuar sipërfaqe prej 5 550 metra katror.

Përgjatë rrugës së re automobilistike janë formuar trotuare të cilat janë shtruar me pllaka begatoni. Rruga automobilistike ndriçohet nga 26 shtylla ndriçuese.

Depërtimi i bulevardit u shfrytëzua për të vendosur kanalizimin atmosferik me profil të ndryshueshëm 300, përkatësisht 400 milimetra.

Qyteti i Shkupit për realizimin e kësaj vepre kapitale shpenzoi rreth 25 milion denarë.

MË PARË





# UNAZË NË RRUGËN “GJORÇE PETROV”

Unaza ndërmjet rrugëve “Gjorçe Petrov”, “Voin Drashkoci” dhe “Radushka” në komunën Gjorçe Petrov, ndërtimin e së cilës Qyteti i Shkupit e përfundoi nga fundi i muajit maj në vitin 2011, zvogëloi në mënyrë të ndjeshme kaosin në qarkullimin rrugor, dhe rriti qarkullimin e automjeteve në këtë pjesë të qytetit. Unaza është formuar në nivelin e rrugës automobilistike ekzistuese, ka dy korsi rrugore me gjerësi nga 7 metra dhe korsi të reja për këmbësorë dhe biçikleta. Në unazë janë vendosur shenja të reja të qarkullimit rrugor, pa semaforë.

Gjatë ndërtimit të unazës, u zgjerua dhe u rregullua hyrja në rrugën “Radushka”. Trotualet dhe korsitë për biçikleta në kryqëzim janë shtuar me pllaka begatoni, kurse korsitë për biçikleta janë shënuar me ngjyrë të kuqe. Janë vendosur edhe shtylla mbrojtëse, kurse ndriçimi i kryqëzimit është rinovuar.



MË PARË

Kanalizimi atmosferik në unazë është rinovuar, me një numër plotësues pusetash.

Ndërtimi i kësaj unaze, të parë, në rrugën “Gjorçe Petrov” paralajmëroi

ndërtimin e unazave në Shkup si një zgjidhje ideale për zvogëlimin e kaosit në kryqëzime dhe për rritjen e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor.



PASTAJ



# RRUGË AUTOMOBILISTIKE RRETHORE TEK KISHA „SHËN PETAR DHE PAVLE“

PASTAJ



Zgjidhje moderne për kaosin në qarkullimin rrugor

Qyteti i Shkupit përfundoi me sukses projektin për ndërtimin e unazës ndërmjet bulevardit “Partizanski odredi”, bulevardit “Makedonska vojska”, rrugës “4.

Juli” dhe rrugës “Luka Gerov”, në komunën Gjorçe Petrov. Kjo zgjidhje moderne e qarkullimit rrugor kontribuoi për përmirësimin e jetës urbane në komunë dhe zvogëlimin

e kaosit që vite me radhë ishte një pamje e zakonshme në këtë kryqëzim.

Në unazën tek kisha „Shën. Petar dhe Pavle” janë formuar 2 korsi rrugore. Është vendosur ndriçim i ri rrugor, dhe është realizuar edhe kanalizim i ri atmosferik. Në hapësirën qendrore të unazës janë mbjellur bar dhe lule.

Para hyrjes në unazë përgjatë katër rrugëve automobilistike janë formuar trotuare të shtruara me pllaka begatoni, kurse bulevardi “Partizanski odredi” është zgjeruar me një korsi rrugore nga ana e djathtë.

Qyteti i Shkupit në këtë punë ndërtimore komplekse investoi rreth 25 milion denarë.

MË PARË





# UNAZË NË RRUGËN “LLAZO TRPOVSKI”

Kryqëzim rrethor u ndërtua ndërmjet rrugëve “Vtora Makedonska Brigada” dhe “Llazo Trpovski”, në kufijtë ndërmjet komunave Butel dhe Çair. Rruga e re automobilistike do të formohet në nivelin e rrugës ekzistuese dhe do të ketë një korsi rrugore me gjerësi 5,5 metra, e cila shërben të katër degët e rrugës së re automobilistike. Në të katër degët e unazës do të formohen ishuj të rinj që do të drejtojnë automjetet drejt unazës.

Në degët e rrugëve “Vtora Makedonska Brigada” dhe “Llazo Trpovski” që çojnë drejt unazës do të formohen trotuare të cilat do të shtrohen me pllaka begatoni me sipërfaqe 900 metra katror. Në mesin e unazës do të mbillet gjelbërim në një sipërfaqe prej 1 400 metra katror.

Gjatë punëve ndërtimore në unazë do të ndërtohet edhe kanalizimi i ri atmosferik i cili do të përcjellë ujërat atmosferik nga rruga automobilistike e re. Do të ndërtohet edhe një pusëtë revizioni me kapak dhe 4 vend derdhje.

Gjatë punëve ndërtimore në unazën ndërmjet rrugëve “Vtora Makedonska Brigada” dhe “Llazo Trpovski” do të kryhet edhe mbrojtja e rrjetit të ujësjellësit ekzistues, e tubave të kanalizimit dhe gazsjellësit. Në unazë do të vendoset edhe ndriçim i ri rrugor.

Ndërtimi i kësaj unaze bëhet me iniciativën e komunave Butel dhe Çair.

Zgjidhja e re rrugore do të kontribuojë për të zgjidhur problemet shumëvjeçare të banorëve në të dy komunat dhe në zvogëlimin e kaosit në qarkullimin rrugor.

Qyteti i Shkupit për këtë projekt do të shpenzohen 22 milion denarë.





# UNAZA ZGJIDHJE PËR KAOSIN EDHE NË KOMUNËN BUTEL

Ekipet e Qytetit të Shkupit në mënyrë të përsheptuar po ndërtojnë unazë ndërmjet rrugëve "Boca Ivanova" dhe "Aleksandar Urdarevski", në komunën Butel. Gjatë kësaj, rrugët "Aleksandar Urdarevski" dhe "Cetinska" do të jenë të ndara fizikisht me trotuar. Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi rreth 23,3 milion denarë.

Unaza ndërmjet rrugëve "Boca Ivanova" dhe "Aleksandar Urdarevski" do të formohet në nivelin e rrugës automobilistike ekzistuese dhe në të do të ketë dy korsi rrugore. Pjesa e mesme do të mbushet me humus dhe do të mbillet bar.

Rruga "Aleksandar Urdarevski" pas rikonstruksionit do të ketë dy korsi rrugore, secila me gjerësi 3,5 metra, kurse nga anët e rrugës do të ndërtohen trotuare me gjerësi të ndryshme dhe korsi për biçikleta me gjerësi 2,5 metra. Në këtë rrugë, janë parashikuar edhe stacione autobusi, nga një në të dy anët.



Rruga "Boca Ivanova" do të ketë dy korsi rrugore me gjerësi 3,5 metra, trotuare nga të dy anët të gjera 3 metra dhe gjelbërim.

Trotuaret në të dy anët e unazës do të shtrohen me pllaka begatoni, me sipërfaqe të përgjithshme 4 910 metra katror. Në trotuaret ndërmjet rrugëve "Aleksandar Urdarevski" dhe "Cetinska" do të vendosen shtylla betoni të cilat do të pen-

gojnë kalimin e automjeteve nëpërmjet trotuarit.

Ndërtimi i unazës në Butel do të shfrytëzohet për rikonstruksionin dhe mbrojtjen e rrjetit ekzistues të ujësjellësit (Ø 300 dhe Ø 400), kurse në një gjatësi prej 127 metra do të ndërtohet rrjeti i ri ujësjellësi me profil Ø 200. Projekti parashikon edhe ndërtimin e kanalizimit atmosferik me gjatësi 300 metra.





# U LIDH KONTRATË PËR NDËRTIMIN E RRUGËS NËNTOKËSORE PRAPA STACIONIT TË VJETËR HEKURUDHOR



Qyteti i Shkupit lidhi kontratë me kompaninë „Limak“ nga Republika e Turqisë me të cilën rregullohen marrë-

dhëniet për ndërtimin e rrugës automobilistike nëntokësore prapa Stacionit të vjetër hekurudhor, në përputhje me Pla-

nin detajues urbanistik për këtë pjesë të qytetit.

Kompania „Limak“ do të ndërtojë rrugën e re automobilistike nën tokë, në thellësi 6 metra. Bulevardi do të jetë i gjatë 800 metra dhe do të ketë nga tre korsi rrugore në çdo drejtim. Pritet që punët ndërtimore në rrugën automobilistike nëntokësore të fillojnë për një vit. Në fillim do të ndërtohet bulevardi, kurse pastaj edhe objektet që do të ndërtohen mbi të – objekte për strehim kolektiv, qendra tregtare dhe afariste dhe hotele. Me këtë marrëveshje praktikisht fillon realizimi i projektit për „Juzhen bulevard“ në Shkup.

Kompania „Limak“, sipas kontratës, pasi të ndërtojë rrugën automobilistike ka për obligim t'ia japë në zotërim Qytetit të Shkupit.


## RRUGË NËNTOKËSORE NË QENDRËN E QYTETIT

Ekspertët e shtëpisë projektuese IDOM, nga Spanja, deri në fund të vitit duhet të përgatisin projektin ndërtimor për rrugën automobilistike që do të shtrihet nga kryqëzimi në bulevardin „Ilin-den“ me bulevardin „Goce Delçev“, pastaj nën bregun „13 Noemvri“ deri te kryqëzimi me bulevardet „Krste Misirkov“ dhe „Koço Racin“.

- Nënshkruam dokumentacionin teknik investues në nivel

projekti themelor për rrugën automobilistike nëntokësore nga ura „Goce Delçev“ deri te Kompleksi i bankave së bashku me rrugët e nevojshme për hyrje dhe dalje. Vlera e projektit ndërtimor është 33 milion denarë, kurse vlera e projektit të qarkullimit rrugor është 5,2 milion denarë me revizion. Vitin e kaluar me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe me Ministrinë për transport dhe lidhje nënshkruam Memorandumin për bashkëpunimin financiar për ndërtimin e rrugës automobilistike e cila parashikohet të kap vlerën 32 milion euro. Deri tani është përgatitur projekti i qarkullimit rrugor, dhe do të vijojë edhe projekti i ndërtimit për rrugën e re automobilistike nëntokësore – sqaroi kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Rruga automobilistike nëntokësore do të jetë e gjatë 1 300 metra, nga të cilët 900 metra janë nën tokë, kurse 400 metra mbi tokë. Rruga automobilistike fillon me unazë tek ura „Goce Delçev“, pastaj shkon nën tokë dhe del në afërsi të Qendrës transportuese, ku duhet të bëhet unazë në kryqëzimin e bulevardit „Krste Misirkov“ me bulevardin „Koço Racin“ dhe „Kuzman Josifovski Pitu“.





Me qëllim rritjen e sigurisë në komunikacion dhe zvogëlimin e kaosit në qarkullimin rrugor në qendrën e qytetit në qershor të vitit 2011u asfaltuan bulevardet "Partizanski odredi", "Krste Misirkov" dhe "Kuzman Josifovski Pitu, si dhe rrugët Vasil Glavinov" dhe "Filip Vtori Makedonski" (rruga që përfshin rrugët e mëparshme "Vasil Haxhillarski" dhe "Stiv Naumov"). Ekipet e Qytetit të Shkupit gërryen shtresën e asfaltit të vjetër dhe të dëmtuar në këto rrugë automobilistike, niveluan pusetat dhe vend derdhjet, rregulluan stacionet e autobusëve dhe shtruan asfalt të ri.

Bulevardi "Partizanski odredi" u rinovua nga kryqëzimi me bulevardin VMRO (objekti Tifani,) deri në kryqëzimin me rrugën "Ruzveltova", me gjatësi 1 300 metra. Rruga "Dame Gruev" u rinovua në gjatësi 250 metra, nga objekti „Tifani“ deri në QT „Paloma Bjanka“.

Rruga "Filip Vtori Makedonski" u rinovua në drejtimin nga Spitali special për sëmundje kirurgjike „Sveti Naum Ohridski“ deri te objekti i TPM, me gjatësi të përgjithshme 850 metra. Asfalti në rrugën "Krste Misirkov" u rinovua nga kryqëzimi „Tërfili“ deri te Pallati i gjyqit, me gjatësi



Bulevardi "Kuzman Josifovski Pitu"



Bulevardi "Partizanski odredi"

## U RINOVUA ASFALTI I BULEVARDEVE NË QENDËR

772 metra. Bulevardi "Kuzman Josifovski Pitu" u rinovua në drejtimin nga Stacioni hekurudhor deri në kryqëzimin me bule-

vardin "Koço Racin", me gjatësi 475 metra.

Për realizimin e punëve ndërtimore të këtyre rrugëve automobilistike të mëdha

Qyteti i Shkupit ndau rreth 150 milion denarë.



Rruga "Filip vtori makedonski"



# ASFALT I RI PËR 32 RRUGË...



## ... NË BULEVARDIN "JANE SANDANSKI", KOMUNA AERODROM



Qyteti i Shkupit këtë vit në një aksion të madh rinovoi rrugën automobilistike "Jane Sandanski" në komunën Aerodrom, nga kryqëzimi me bulevardin "Serbia" deri në kryqëzimin tek objekti „Mekdonalds“, në gjatësi 700 metra, në të dy drejtimet.

Asfalti i dëmtuar në këtë rrugë automobilistike është gërvishur, dyshemeja është forcuar dhe është shtuar shtresë e re asfalti. Në pjesë të veçanta janë riparuar edhe trotuaret.

Qyteti i Shkupit në këtë projekt investoi rreth 29,2 milion denarë. Bulevardi "Jane Sandanski" është ndërtuar në fillim të viteve `80-të dhe deri tani asnjëherë nuk është rinovuar. Asfalti i tij ishte dëmtuar shumë dhe çdo vit ekipet e Qytetit të Shkupit realizonin aksione për mbulimin e gropave të mëdha që nuk ishte e mjaftueshme për zhvillimin e sigurt të qarkullimit rrugor. Që këtu edhe nevoja për rikonstruksionin e plotë të bulevardit "Jane Sandanski".



# ... NË RRRUGËN "KOZLE", KOMUNA KARPOSH

MË PARË



nga stacioni i fundit i autobusit numër 57 deri në kryqëzimin me rrugën "Nereshka". Është vendosur edhe kanalizim i ri atmosferik me gjatësi 655 metra.

Rikonstruksioni i kësaj rruge automobilistike të rëndësishme u zhvillua në dy faza. Në vitin 2011 u rinovuan 444 metra në rrugën "Kozle", nga stacioni i fundit i autobusit me numër 57 deri në kryqëzimin me rrugën "Jurij Gagarin".

Këtë vit u rinovuan edhe 856 metra të rrugës "Kozle", nga kryqëzimi me rrugën "Jurij Gagarin" deri në kryqëzimin me rrugën "Nereshka".

Për punët ndërtimore Qyteti i Shkupit ndau rreth 33,5 milion denarë.

Ekipet e Qytetit të Shkupit rinovuan rrugën "Kozle" në komunën e Karposhit. Në

gjatësi 1 300 metra kjo rrugë u shtrua me asfalt të ri dhe trotuare të reja, në drejtimin

PASTAJ





# ...PËR RRUGËN "SAMOILOVA", KOMUNA ÇAIR DHE QENDËR

Me realizimin e suksesshëm të projektit për rikonstruksionin e rrugës "Samoilova", kjo rrugë e rëndësishme automobilistike mori një pamje moderne. Rruga automobilistike këtë verë u rinovua në gjatësi 1 300 metra, nga fillimi i kalldrëmit nën Kalanë e Shkupit deri në godinën e Ambasadës amerikane.

Në mënyrë që të ruhet autenticiteti i ambientit gurët kubik në rrugën "Samoilova" u rregulluan përsëri në gjatësi prej rreth 200 metrash, kurse në pjesën tjetër u shtrua me asfalt të ri. Janë rregulluar edhe trotuaret dhe gjelbërimi anësor. Për rinovimin e rrugës "Samoilova" Qyteti i Shkupit



shpenzoi rreth 35 milion denarë.

Gjatë punëve ndërtimore në rrugën "Samoilova", NP "Ujësjellës dhe kanalizim" rinovoi të gjitha lidhjet

drejt rrjetit ekzistues të ujësjellësit përgjatë trasesë së rinovuar, si dhe disa lidhje drejt rrjetit të kanalizimit.





# ...RRUGA “RADISHANSKA”, KOMUNA BUTEL

Në komunën Butel, u shtrua me asfalt të ri rruga “Radishanska”, me gjatësi 1 700 metra, nga hyrja e tretë e lagjes Radishani deri te ura. Rinovimi i rrugës “Radishanska” u realizua në dy faza. Në vitin 2011 u rinovua pjesa pranë tre hyrjeve në lagje, kurse gjatë verës u riparua pjesa e hyrjes së parë në lagjen Radishani deri tek ura. Me aktivitetet ndërtimore të Qytetit të Shkupit rruga automobilistike e gërmuar dhe gërmimet e thella që kërcënonin sigurinë e qytetarëve tashmë janë e kaluar, kurse rruga “Radishanska” mori një pamje krejtësisht të re.

Për realizimin e këtij projekti ndërtimor Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 19 milion denarë.



## PASTAJ



# ... RRUGA NË FSHATIN KRUSHOPEK, KOMUNA SARAJ

Rruga në fshatin Krushopek, në komunën e Sarajit, u rinovua në qershor të vitit 2011. Pjesa e rinovuar është e gjatë 1 200 metra, dhe e gjerë 4,5 metra.

Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunës së Sarajit. Për rinovimin e rrugës "Krushopek" janë shpenzuar 14 milion denarë, kurse Qyteti i Shkupit mori pjesë me 8,5 milion denarë.







# ... RRUGA "VOLKOVSKA", KOMUNA GJORÇE PETROV

PASTAJ



Qyteti i Shkupit investoi rreth 28 milion denarë për zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës "Volkovska", në komunën Gjorçe Petrov. Rinovimi i rrugës "Volkovska" u krye në dy faza.

Në vitin 2010 u rinovua një pjesë e rrugës "Volkovska" me gjatësi 1 700 metra, nga hekurudha deri në qendrën e lagjes Volkovë. Në vitin 2011 kjo rrugë u shtrua me asfalt të ri në drejtimin nga qendra e vendbanimit Volkovë deri në stacionin e fundit të autobusit me numër 22. Rruga automobilistike në këtë pjesë është zgjeruar dhe rinovuar në gjatësi 1 300 metra.



# ... NË RRUGËN "PELAGONIJA", KOMUNA SHUTO ORIZARE

PASTAJ



Asfalt i ri u shtrua në rrugën "Pelagonija", në komunën Shuto Orizare. Rruga automobilistike është rinovuar në gjatësi 1 070 metra gjë për të cilën Qyteti i Shkupit ndau 7,2 milion denarë. Janë riparuar edhe trotualet e dëmtuara.

Ky është rikonstruksioni i parë i rrugës "Pelagonija" pas 40 vitesh. Qytetarët e komunës Shuto Orizare me këtë aksion të Qytetit të Shkupit u bënë me rrugë të re dhe kushte më të mira për zhvillimin e

qarkullimit rrugor.

Punët ndërtimore i realizoi

ndërmarrja publike „Rrugë dhe rrugica”.

MË PARË





# ... PËR RRUGËN "BLAGOJA STEFKOVSKI", KOMUNA GAZI BABA

Rruga "Blagoja Stefkovski" në komunën Gazi Baba u shtrua me asfalt të ri në vitin 2010. Në drejtimin nga hyrja në Maxhari deri në mbikalimin drejt lagjes Çento kjo rrugë

automobilistike u rinovua në gjatësi 800 metra.

Në këtë punë ndërtimore rruga "Blagoja Stefkovski" u bë me kanalizim të ri, me

profil 800 milimetra.

Për rinovimin e kësaj rruge Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 26 milion denarë.



## U ZGJERUA PJESA E RRUGËS "BLAGOJA STEFKOVSKI"



Për të zgjidhur problemet shumëvjeçare në qarkullimin rru- gor, ekipet e Qytetit të Shkupit këtë verë zgjeruan edhe rrugën "Blagoja Stefkovski", tek kryqëzimi me degën në rrugën "Pero Nakov", në gjatësi 220 metra. Zgjerimi është realizuar në anën e majtë të rrugës, e shiku- ar në drejtimin nga Maxhari, me tre korsi rrugore, trotuar dhe korsi për biçikleta.

Qyteti i Shkupit në këtë punë ndërtimore investoi rreth 8 milion denarë.

## ... RRUGA "FERID BAJRAM", KOMUNA BUTEL



MË PARË

vendosur bordura të reja.

Rruga automobilistike në rrugën "Ferid Bajram" ishte shumë e dëmtuar. Punët ndërtimore u kryen gjatë muajve të verës kur intensiteti i komunikacionit në qytet është më i vogël.

Rinovimi i rrugës "Ferid Bajram" kontribuoi në rritjen e qarkullimit të automjeteve nëpër këtë rrugë automobilistike dhe rritjen e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor.

Rruga automobilistike "Ferid Bajram" u rinovua në qershor të vitit 2010.

Pjesa e rinovuar është e gjatë 800 metra, është shtruar shtresë e re asfalti dhe janë

Rikonstruksioni i rrugës "Ferid Bajram" Qytetit të Shkupit i kushtoi 6,5 milion denarë.



PASTAJ



Qyteti i Shkupit në vitin 2010 shpenzoi rreth 11,4 milion denarë për rikonstruksionin e plotë të rrugës “Kemal Sejfulla” në lagjen e Çairit.

Asfalti i vjetër u zëvendësua me asfalt të ri dhe rruga mori një pamje krejtësisht të re. Kaosi që krijohet në këtë grykë të ngushtë të qarkullimit rrugor nuk është më pamje e zakonshme për këtë rrugë të qytetit.




## ...RRUGA “KEMAL SEJFULLA”, KOMUNA E ÇAIRIT

PASTAJ





# ... NË RRUGËN “SVETI KIRIL I METODIJ”, KOMUNA QENDËR



Rruga “Sveti Kiril i Metodij” (rruga e mëparshme “Mito Haxhivasilev Jasmin”), në qendrën e qytetit, mori pamje të re. Rruga automobilistike është rinovuar nga kryqëzimi me bulevardin “Koço Racin” deri në kryqëzimin me bulevardin “Sveti Kliment Ohridski”, me gjatësi rreth 800 metra. Qyteti i Shkupit për këtë projekt nga Buxheti shpenzoi rreth 16 milion denarë.





# RRUGA "JUZHNMORAVSKI BRIGADI", DREJT VARREZAVE KAMNIK, KOMUNA GAZI BABA

MË PARË



Dega nga rruga "Juzhnomoravski brigadi" që çon deri te varrezat Kamnik në vitin 2011 u zgjerua dhe u rinovua në gjatësi 756 metra. Rruga ka dy korsi rrugore dhe trotuare të reja.

Për realizimin e këtij projekti, i cili është investim i përbashkët i Qytetit të Shkupit dhe komunës Gazi Baba, u shpenzuan rreth 23,5 milion denarë, nga të cilat Qyteti i Shkupit siguroi 75 për qind.

PASTAJ



PASTAJ

# ... NË 4 RRUGË NË KOMUNËN SHUTO ORIZARE

Me kërkesë të banorëve përreth Qyteti i Shkupit në vitin 2010 asfaltoi rrugët „17“, „19“, „30“ dhe „33“, në komunën Shuto Orizare. Në këtë aksion të Qytetit të Shkupit u asfaltuan gjithsej 4 000 metra rrugë automobilistike dhe u zgjidh një nga problemet më të mëdha urbane me të cilin ballafaqoheshin vite me radhë qytetarët në këtë pjesë të qytetit.

Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit shpenzoi 12 milion denarë.





# ... NË RRUGËT RRETH ARENËS „FILIPI I DYTË“, KOMUNA QENDËR



Në fazën përfundimtare janë punët ndërtimore në rrugët rrethore tek arena kombëtare „Filipi i dytë“. Investimi është me vlerë rreth 35 milion denarë, në të cilin me një të tretën e mjeteve marrin pjesë Qyteti i Shkupit, SHA për ndërtimin dhe menaxhimin me hapësirat banesore dhe afariste dhe komuna Qendër.

Projekti për ndërtimin e rrugëve rrethore tek stadiumi përfshin ndërtimin e rrjetit të kanalizimit, rrugë automobilistike dhe trotuare dhe ndriçim të plotë.

## ... RRUGA „IVAN KOZAROV“, KOMUNA KISELA VODA

Në drejtimin nga kryqëzimi me rrugën „Dositej Obradović“ deri në kryqëzimin me rrugën „Bozhidar Axhija“, në vitin 2010 u shtrua me asfalt të ri rruga „Ivan Kozarov“, në lagjen Kisela Voda. Qyteti i Shkupit rinovoi pjesën me gjatësi 340 metra, kurse për punët ndërtimore shpenzoi rreth 3 milion denarë.

Rikonstruksioni i rrugës „Ivan Kozarov“ mundësoi qarkullim më të madh të automjeteve nëpër këtë rrugë automobilistike dhe siguri më të madhe në qarkullimin rrugor.



## ... PËR 5 RRUGË NË LAGJEN USJE, KOMUNA KISELA VODA



Disa rrugë në lagjen Usje, të cilat para shumë vitesh ishin gërmuar për shkak të vendosjes së rrjetit të ujësjellësit, në vitin 2011 u shtruan me asfalt të ri. U zgjerua dhe asfaltua rruga numër 1, me gjatësi 400 metra, si dhe rrugët numër 2, numër 3, numër 4 dhe numër 22 me gjatësi të përgjithshme 600 metra.

Qyteti i Shkupit për këtë projekt ndau 3,3 milion denarë, kurse në terren punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“.

## ... PËR RRUGËN DREJT HIPODROMIT, KOMUNA GAZI BABA

Në rrugën drejt lagjes Hipodrom, nga hekurudha në Maxhari deri në qendrën sportive në Hipodrom, në vitin 2011 u shtrua shtresë e re asfalti, gjë me të cilën rruga automobilistike mori pamje të re. Rruga është e gjatë 1 100 metra.

Në këtë punë ndërtimore Qyteti i Shkupit investoi rreth 4 milion denarë, kurse rikonstrukcionin e realizuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“.






## ... PËR RRUGËN KO- PANICË-RAS- HÇE, KOMU- NA SARAJ

Në vitin 2009 u ndërtua rrugë e asfaltuar ndërmjet fshatrave Kopanicë dhe Rashçe, në komunën e Sarajit. Pjesa e rinovuar e rrugës është e gjatë 3,8 metra.

Rinovimi i kësaj rruge u lehtësoi qasjen banorëve të dy fshatrave deri në Shkup dhe mundësoi lidhjen me unazën Shkup – Tetovë. Për rikonstruksionin e rrugës Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 5 milion denarë.

PASTAJ



PASTAJ



## ... PËR RRUGËN DREJT INXHI- KOVËS, KOMUNA GAZI BABA

Edhe rruga në lagjen Inxhikovë në komunën Gazi Baba u shtrua me asfalt të ri, në drejtimin nga Fshati i fëmijëve SOS deri te ura në Inxhikovë. Gjatë punëve ndërtimore në rrugën automobilistike u riparuan gërmimet nga rrjeti i ujësjellësit i vendosur më parë dhe u asfaltua sipërfaqe e përgjithshme prej rreth 1 800 metra katror.

Rruga është e gjatë 420 metra, kurse për punët ndërtimore Qyteti i Shkupit shpenzoi 1,2 milion denarë.

## ... PËR RRUGËN NË VIZBEG, KOMUNA BUTEL

Ekipet e Qytetit të Shkupit rinovuan rrugën në zonën industriale Vizbeg, që lidh rrugën e Kaçanikut me bulevardin "Slovenia". Pjesa e rinovuar është e gjatë 300 metra dhe me dy korsi rrugore. Rruga është me rëndësi të madhe për firmat dhe kompanitë nga zona industriale Vizbeg sepse siguron qasje të lehtë deri

në objektet e tyre.

Qyteti i Shkupit në këtë punë ndërtimore investoi 5 milion denarë, kurse në të ardhmen do të përkrah zhvillimin ekonomik lokal.



Në vendbanimin Vizbeg është asfaltuar rrugë me gjatësi 900 metra dhe është vendosur ndriçim i ri rrugor. Ndërtimi i rrugës kushtoi 12 milion denarë nga të cilat 50 për qind janë mjete të Qytetit të Shkupit, kurse 50 për qind të komunës Butel.

**PASTAJ**





## ... PËR RRUGËN "PERE TOSHEV", KOMUNA E ÇAIRIT

Rruga automobilistike "Pere Toshev", në Çair, vitin e kaluar u rinovua në gjatësi 180 metra dhe tani është e gjerë 6 metra. Për këtë punë ndërtimore Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 1,8 milion denarë.

Me rinovimin e rrugës automobilistike "Pere Toshev", Qyteti i Shkupit zgjidhi problemet shumëvjeçare të banorëve të tij, dhe rriti sigurinë në qarkullimin rrugor.



## ... PËR RRUGËN NGA VOLKOVA DERI NË UNAZË, KOMUNA GJORÇE PETROV

Rrugë me gjatësi 846 metra lidh vendbanimin Volkovë me unazën veriore. Rruga automobilistike ka dy korsi rrugore me gjerësi 3,5 metra dhe me trotuare me gjerësi 2,5 metra.

Për ndërtimin e kësaj rruge hyrëse nga arka e qytetit u ndanë 12 milion denarë.



## ... PËR RRUGËN "4. JULI", KOMUNA GJORÇE PETROV

Ekipet e Qytetit të Shkupit asfaltuan pjesën e rrugës "4. Juli" në komunën Gjorçe Petrov në drejtimin nga objekti i Gjeriatriisë drejt kishës „Shën. Petar dhe Pavle”. Rruga automobilistike u rinovua në gjatësi 240 metra. Rruga automobilistike është e gjerë 9 metra.



## ... PËR RRUGËN "BELGRADSKA", KOMUNA QENDËR

PASTAJ



Qyteti i Shkupit dhe NP „Rrugë dhe rrugica” rinovuan asfaltin në rrugën "Belgradska", në komunën Qendër, nga kryqëzimi me rrugën "Vodnjanska" deri në rrugën "Dimitar Mitrev", me gjatësi 550 metra. Qyteti i Shkupit në këtë punë ndërtimore investoi rreth 5 milion denarë.



# ... NË RRUGËN “VASIL GJORGOV”, KOMUNA QENDËR

## PASTAJ



Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe komunës Qendër rinovuan rrugën “Vasil Gjorgov” e cila u shtrua me asfalt të ri nga kryqëzimi me bulevardin “Vodnjanska” deri te qendra e vjetër tregtare në Kapishtec. Vetë kryqëzimi është zgjeruar për të mun-

dësuar qarkullimin më të madh të automjeteve. Janë rinovuar edhe trotuare nga të dyja anët e rrugës automobilistike dhe janë shtruar me pllaka me elementë pauer.

Më parë, në pjesën nga bulevardi “Vodnjanska” deri te godina e „Zhito Luks”,

u vendos kanalizimi atmosferik.

Rinovimi i rrugës “Vasil Gjorgov” është investim i përbashkët i Qytetit të Shkupit dhe komunës Qendër.

## U VENDOS SISTEMI INFORMATIV GJEOGRAFIK

Qyteti i Shkupit vendosi Sistemin informativ gjeografik (SIGJ) në punën e administratës, që është një nga kushtet për punë të suksesshme dhe plotësimin e detyrës primare të tij si servis i qytetarëve. Me vendosjen e SIGJ përgatiten shpejt të dhënat dhe sillen vendime për shumë çështje komplekse siç është planifikimi dhe rregullimi i hapësirës.



## PËR HERË TË PARË – TROTUAR NË RRUGËN REGJIONALE SHKUP – KATLANOVË...

Nëpër vendbanimin Trubarevo, përgjatë rrugës regjionale Shkup – Katlanovë (P-303), në vitin 2010 për herë të parë u ndërtua trotuar. Qyteti i Shkupit me këtë vepër ndërtimore zgjidhi një pjesë të problemeve në këtë pjesë të qytetit dhe kontriboi të rritet në mënyrë të ndjeshme siguria e këmbësorëve dhe çiklistëve.

Në ndërtimin e trotuareve në Trubarevo punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“. Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi rreth 3 milion denarë.

### ...NË RRUGËN “SKUPI”...

Trotuar i ri është ndërtuar edhe përgjatë rrugës “Skupi”, në drejtimin nga ura në lumin Lepenec deri në rrugën për Bardovci, me gjatësi 800 metra.

Në rrugën “Skupi” më parë nuk kishte trotuar. Për ndërtimin e kësaj korsie për këmbësorët Qyteti i Shkupit shpenzoi 3,2 milion denarë.



### ...DHE NË BULEVARDIN “NIKOLLA KAREV”

Në vitin 2010 për herë të parë u ndërtua trotuar përgjatë bulevardit “Nikolla Karev”, nga poliklinika „Bit-Pazar“ drejt hotelit „Kontinental“.

Korsia e këmbësorëve është ndërtuar edhe në pjesën tjetër të bu-

levardit, nga kryqëzimi „Tërfili“ deri në kryqëzimin tek hoteli „Kontinental“, me gjatësi 500 metra.

Në terren punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“.





# PAMJE E RE PËR TROTUARET NË QENDËR

Trotuaret e dëmtuara të cilat vite me radhë krijonin probleme në lëvizjen e këmbësorëve nëpër qendrën e qytetit në vitin 2011 u gërmuan plotësisht dhe u shtruan me pllaka begatoni parafabrikat. Me këtë projekt voluminoz të Qytetit të Shkupit trotuaret përgjatë gjashtë kryqëzimeve kryesore në qendër morën pamje të re. Për këtë projekt Qyteti i Shkupit ndau rreth 32 milion denarë.

Në aksionin e Qytetit të Shkupit u rinovuan trotuaret në të dy anët e bulevardit "Goce Delçev", nga ura „Goce Delçev” deri në kryqëzimin me rrugën "Vasil Haxhillarski"; korsa për këmbësorë në bulevardin "Partizanski odredi", para Kishës; trotuari në një pjesë të bulevardit "VMRO" dhe para objektit të BPU „Sveti Kliment Ohridski"; korsa për këmbësorë përgjatë



Rruga "11 Oktomvri"

rrugëve "Filip vtori Makedonski" dhe "11 Oktomvri", tek parku „Zhena-borec"; si dhe korsa për këmbësorë në rrugën "Vasil Glavinov" dhe në një pjesë të bulevardit

"Ilinden", nga ura „Goce Delçev” deri në godinën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.



Rruga "Vasil Glavinov"



Bulevardi "Partizanski odredi"



Bulevardi "Goce Delçev"



Bulevardi "VMRO"



# PO NDËRTOHET URË E RE MBI LUMIN SERAVA

Shtrati i lumit Serava në rrjedhjen e lumit Vardar do të bëhet me urë të re. Ura e re lidh korsinë e patinave-biçikletave në anën e majtë të lumit Vardar e cila në atë pjesë ishte ndërprerë. Me ndërtimin e urës mbi lumin Serava qytetarëve të Shkupit iu mundësua lëvizje e pandërprerë nëpër korsi, nga ura tek hoteli „Aleksandar Palas“ deri në urën „Todor Aleksandrov“ (ura e mëparshme „Bliznak“). Qyteti i Shkupit për ndërtimin e kësaj ure shpenzoi rreth 4,8 milion denarë.

Ura e re mbi lumin Serava është prej betoni të armuar, është e gjatë 16,6 metra, dhe e gjerë 4,6 metra. Rrethimi



mbrojtës është përgatitur prej tubash çeliku, kurse ndriçimi i urës është mundësuar me llambat që ndriçojnë korsinë

e patinave-biçikletave nga ana e majtë e lumit Vardar.





# Pas 50 vitesh URË E RE MBI LUMIN VARDAR

Mbi lumin Vardar në Saraj u ngrit urë e re dhe moderne. Kalimi i ri nëpërmjet Vardarit është prej betoni të armuar, në tre harqe, dhe me gjatësi 50 metra. Në urë janë ndërtuar dy korsi rrugore, korsi për biçikleta dhe këmbësorë. Rrethimi mbrojtës i urës së re në korsinë e këmbësorëve është prej

çeliku, kurse nga ana tjetër e urës rrethimi mbrojtës është prej betoni. Ura ndriçohet me kandelabër çeliku.

Vlera e këtij projekti kapital është rreth 96,8 milion denarë, mjete të siguruara nga Qyteti i Shkupit, komuna e Sarajit dhe nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Ndërtimi i urës së re mbi lumin Vardar mundësoi lidhje të mirë të qarkullimit rrugor ndërmjet vendbanimeve Gjorçe Petrov dhe Saraj, si dhe lidhje të shkëlqyer me qendrën rekreative sportive „Matka“.

MË PARË



PASTAJ



MË PARË



## PAMJE E RE PËR URËN „GOCE DELÇEV“ ...

Ura „Goce Delçev“ në vitin 2011 u bë me rrethim mbrojtës dhe ndriçim të ri. Rrethimi i ri është përgatitur nga profile tubash dhe është i përbërë prej 148 elementesh montuese të cilat lidhen me shtylla. Për rinovimin

e urës „Goce Delçev“ Qyteti i Shkupit investoi rreth 30 milion denarë.

Në urë është vendosur edhe ndriçim i ri me 26 kandelabër, kurse në shtyllat me lartësi 10 metra deri në rrethimet mbrojtëse të

brendshme janë vendosur llamba më moderne, në konzula dekorative. Për ndriçimin e urës „Goce Delçev“ Qyteti i Shkupit ndau 3,7 milion denarë.







## ...EDHE PËR „URA E REVOLUCIONIT“

Edhe „Ura e Revolucionit“ mori një pamje moderne. Në kalimin që lidh bulevardet “Koço Racin” dhe “Krstë Misirkov” u rinovuan trotuaret, rrethimi mbrojtës dhe ndriçimi i rrugëve. Janë riparuar edhe pjesët e betonit të dëmtuar në anën e jashtme të urës.

Rrethimi i ri mbrojtës është prej hekuri të farkëtuar. Në të janë montuar 22 kandelabër dekorativë. Ura në mënyrë plotësuese ndriçohet nga 10 shtylla të ndriçimit rrugor, kurse konturet e urës i thekson ndriçimi në formë linje.

Për rinovimin e urës së Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 27,6 milion denarë.

MË PARË



# PO RINOVHEN FASADAT NË QENDËR



Objekti mbi restorantin „Pelister” në rrugën “11. Oktomvri” numër 2 dhe ndërtesa në rrugën “Marshall Tito” numër

22 u bënë me fasadë të re.

Pjesa përfundimtare e fasadës është prej guri të thërrmuar travertit, kurse

në disa vende prej bakri dhe hekuri të farkëtuar. Qyteti i Shkupit për rikonstruksionin e fasadës të „Pelister” nga Buxheti ndau rreth 14,7 milion denarë.



Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë punojnë në rikonstruktionin e fasadës në një pjesë të objektit në rrugën “11 Oktomvri” numër 2, hyrja 1, 2, 3, 4 dhe 5, që përbën vazhdimin e objektit nga restoranti „Pelister” drejt sheshit „Pela”.

Për rikonstruktionin e fasadës së këtij objekti janë përdorur materiale autentike natyrore – travertin dhe teraco travertin në kombinim me elementë përfundimtar dekorativ parafabrikat betoni. Fasada u rinovua në stilin klasik.

Qyteti i Shkupit në këtë projekt do të investojë rreth 28,8 milion denarë.



## PASTAJ



Pamje të re mori edhe ndërtesa në rrugën "Nikolla Vapcarov" numër 2, objekti mbi kafenenë „Trend”. Me këtë projekt Qyteti i Shkupit rinovoi fasadën në pjesën ballore të objektit e cila shikon nga sheshi i qytetit.

Punët rinovuese në këtë objekt u realizuan në një sipërfaqe 210 metra katror, ku u rregullua pjesa sipërfaqësore e fasadës me material natyror dhe me izolim adekuat.

Rikonstrukcioni i kësaj fasade kushton rreth 3,5 milion denarë.



## SHTËPIA E QYTETIT NË BREGUN E LUMIT VARDAR



Në vijim është ndërtimi i objektit administrativ-afarist për nevojat e administratës së Qytetit të Shkupit, në rrugën "Llazar Liçenoski" nën Kalanë e Shkupit. Godina do të ketë kat përdhës dhe pesë kate dhe ambiente pune për 650 të punësuar.

Fasada e objektit do të jetë në stilin neoklasik, ku do të respektohen të gjitha standardet për kursimin e energjisë.



Objekti i QKR me pamje të re

## U RINOVUA OBJEKTI I QENDRËS KULTURORE RINORE...

Objekti i Qendrës kulturore rinore në fillim të vitit mori pamje të re. Me mjetet e marra nga IPA Programi i Bashkimit Evropian, me vlerë 35 000 000 denarë, është përfunduar edhe rikonstruksioni i çatisë së objektit, rikonstruksioni i fasadës, i nyjave sanitare dhe i tualeteve. Qyteti i Shkupit si



Rikonstruksioni i tualeteve



Salla e vallëzimit QKR

investitor i përbashkët në rikonstruksion siguroi mjete për blerjen e pajisjeve audio dhe të ndriçimit në vlerë prej 8 320 000 denarë.

Me mjetet e Qytetit të Shkupit në vlerë prej 7 250 000 denarë janë riparuar salla e koncerteve dhe kinemaja „Frosina” në QKR.



# ... SALLONI 19:19...



Salloni 19:19 në Qendrën kulturore rinore u rinovua plotësisht.

Me investimin e Qytetit të Shkupit prej 3,5 milion denarë u realizua riparimi i çatisë, i dhomave të grimit, tualeteve, gar-

dërobave dhe ambienteve të tjera ndihmëse, kurse u rinovua edhe salla hyrëse në Sallon. Donacioni prej 7 milion denarësh nga fondacioni IMAC nga SHBA është shfrytëzuar për rinovimin dhe rregullimin e en-

terierit të sallës, ku janë montuar ndenjësë të reja, u rinovua plotësisht konstruksioni skenik, u përmirësua edhe guaska akustike e Sallonit, është vendosur edhe ndriçim i ri dhe aklimatizim qendror i ambientit.



# ...EDHE PËR QKF „KARPOSH“

Godina e Qendrës kulturore të fëmijëve „Karposh“, në bulevardin „Ilinden“, është rinovuar plotësisht. Brendësia e godinës është rinovuar dhe pajisur me mobilie të reja. Fasada e objektit është restauruar me ngjyrën e saj autentike në tre ngjyra: një për muret, ngjyrë tjetër për kapitelet e dritareve dhe ngjyra e tretë për kursorat që janë dekor i vetë fasadës.

Godina në të cilën punon Qendra kulturore e fëmijëve „Karposh“ është një nga objektet kulturore më të rëndësishme



MË PARË

të qytetit. Me aksionin e Qytetit të Shkupit, iu kthye shkëlqimi i vjetër i pjesës së jashtme të objektit, dhe u përmirësua edhe funksionaliteti i brendësisë së tij.

Në rinovimin e Qendrës kulturore të fëmijëve Qyteti i Shkupit investoi rreth 6 milion denarë.





## U RREGULLUA SHESHI RRETH KRYQIT TË MIJËVJEÇARIT ...



Qyteti i Shkupit vitin e kaluar investoi rreth 4,7 milion denarë për rregullimin e sheshit rreth Kryqit të mijëvjeçarit.

Rreth Kryqit të mijëvjeçarit janë formuar dy platforma rrethore, kurse sipërfaqja është shtruar me tipa të ndryshëm gurësh të cilët janë në har-

moni me ambientin malor. Në rrathët e sheshit janë vendosur pajisje urbane – stola, kosha për mbeturina dhe ndriçim.



## ... DHE PARA KISHËS „SHËN. SPAS“

Pllakat e gurit të vjetra dhe të thyera të sheshit para kishës „Shën. Spas“ në aksionin e Qytetit të Shkupit u

zëvendësuan me gurë kubik, gjë me të cilën sheshi mori një pamje autentike.

Para kishës „Shën. Spas“ është ri-

novuar sipërfaqja prej 270 metra katror, gjë për të cilën Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth një milion denarë.

## LLAMBA NDRIÇUESE TË REJA NË PARKUN E QYTETIT ...

Në pjesën e parë të Parkut të Qytetit janë vendosur 27 shtylla të reja metalike dekorative me lartësi 5 metra, në të cilat janë montuar llamba me fuqi 70W. Që të unifikohej pamja dhe tipi i shtyllave dhe llambave në pjesë të caktuara të parkut është kryer edhe dislokimi i 10 shtyllave ekzistuese me llamba.

Në suazat e aksionit për ndriçimin e parkut, janë vendosur 7 reflektorë me burime halogjeni ndriçimi me fuqi 50W për ndriçimin e shatërvanit „Heptagon“, si dhe dy transformatorë.

Qyteti për këtë projekt nga buxheti ndau 2,6 milion denarë.



## ...NË KORSINË E KËMBËSORËVE NË GJORÇE PETROV ...

Njëqind e njëzet e katër shtylla nga viti i kaluar ndriçojnë korsinë e këmbësorëve pranë lumit vardar në komunën Gjorçe Pet-

rov, në drejtimin nga ura e re deri në fabrikën „Kupro“. Në çdo shtyllë ndriçimi është montuar nga një llambë me fuqi 100 W.

Vendosja e llambave të reja kushtoi rreth 6 milion denarë.

## ...DHE NË NJË PJESË TË BULEVARDIT “BORIS TRAJKOVSKI”



Qyteti i Shkupit vendosi ndriçim të ri publik në bulevardin “Boris Trajkovski”, nga lagjja Pintija deri në urën e Markova reka, para lagjes Draçevë. Ky drejtim vite me radhë ishte pa ndriçim rrugor dhe përbënte rrezik për sigurinë në qarkullimin rrugor. Prandaj, ekipet e Qytetit të Shkupit vendosën 52 shtylla druri me llamba në pjesën me gjatësi 1 550 metra.

Nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për realizimin e këtij projekti janë ndarë 791 902 denarë.






# KANDELABËR NDRIÇUAN ÇARSHINË E VJETËR TË SHKUPIT

U rinovua plotësisht ndriçimi në Çarshinë e vjetër të Shkupit. Me projektin për rikonstruksionin dhe adaptimin e ndriçimit në bërthamën e vjetër të qytetit janë ndriçuar rrugët "Bitpazarska", "Drvarska", "Çarshia e mbuluar", "Gradishte", "Llazar Tanev", "Podgragje", "Jorgaxhinska", "Makarija Frçkovski", "Kazanxhiska", 694, "Qursiçka", "Evlija Çelebija", 412, "Papuxhiska", "Petar Mihov", "Teodosij Gologanov", "Kovačka" dhe "Samarxhiska".

Janë vendosur 462 fenerë dekorativ alumini.

Për realizimin e këtij projekti janë investuar rreth 30 milion denarë, kurse shpenzimet me vlerë 50 për qind janë siguruar nga Qyteti i Shkupit, kurse 50 për qind nga komuna e Çairit.





## LLAMBA NDRIÇUESE PËR KORSINË E PATINAVE NË ANËN E MAJTË TË LUMIT VARDAR

Për ndriçimin e korsisë së patinave nga ana e majtë e lumit Vardar, në drejtimin nga ura „Goce Delçev“ deri në bulevardin „8. Septemvri“ janë vendosur 98 shtylla me lartësi 6 metra. Në çdo shtyllë është vendosur nga një llambë kursyese me fuqi 150W.

Mjetet financiare në vlerë prej rreth 5 milion denarë për realizimin e këtij projekti janë siguruar plotësisht nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.

Vendosja e ndriçimit në korsinë e këmbësorëve dhe patinave në të dy anët e lumit Vardar është pjesë e aktiviteteve në kontinuitet që Qyteti i Shkupit i ndërmer për rregullimin e bregut të lumit të qytetit dhe mundësimin të kushteve optimale për rekreacion për qytetarët.



Ekipe e Qytetit të Shkupit ndriçuan edhe korsinë e patinave-biçikletave në anën e majtë të lumit Vardar, nga ura tek „Holidëj in“ deri te ura „Todor Aleksandrov“ (ura e mëparshme „Bliznak“). Përgjatë korsisë janë vendosur 123 shtylla me lartësi 6 metra dhe 123 llamba me fuqi 150 W.

Për ndriçimin e kësaj pjese të korsisë së patinave-biçikletave Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 4 milion denarë.





## U NDRIÇUA RRUGA NGA GLUMOVA DERI NË MATKA

Rruga nga fshati Glumovë deri në hyrjen e hidrocentralit „Matka” këtë vit u ndriçua plotësisht. Traseja në të cilën është ndërtuar ndriçimi i ri rrugor është me gjatësi rreth 2 kilometra dhe në të janë vendosur 64 shtylla me lartësi 8 metra. Në çdo shtyllë është vendosur llambë me fuqi 150 W.

Ndriçimi kontribuoi për shikimin më të mirë të rrugës, gjë me të cilën u rrit siguria e banorëve në të dy fshatrat, e pronarëve të vilave në rrethinat e Matkës, si dhe e turistëve të cilët në orët e mbrëmjes vizitojnë kanionin e Matkës.


Vlera e përgjithshme e punëve të realizuara është rreth 5 milion denarë.



# PARKIMI ZONAL NË SHKUPË

Parkimin zonal që e promovoi Qyteti i Shkupit në vitin 2009 vendosi rregull në parkim dhe mundësoi rritjen e numrit të vendeve të parkimit në qytet. Ky sistem parkimi përbëhet nga katër zona: zona e kuqe A, zona e verdhë B, zona e gjelbër C dhe zona e bardhë D, të cilat dallohen sipas kohëzgjatjes së parkimit dhe çmimit për një orë parkim.

Projekti për parkimin zonal filloi në territorin e qendrës së qytetit, që më vonë të zgjerohej edhe në komunat e tjera të Shkupit. Sipas rregullave të parkimit zonal, në zonën A parkimi lejohet deri në 2 orë dhe kushton 45 denarë për një orë. Në zonën B



**ЗОНСКО ПАРКИМ**  
**ПАРКИРАЊЕ ЗОНАЛ**  
ПОВЕЌЕ МЕСТО ЗА СИТЕ! МË SHUMË VEND PËR TË GJITHË

qëndrimi është deri në 4 orë, me çmim 35 denarë për një orë. Në zonën e gjelbër C dhe zonën e bardhë D parkimi është me kohë të pakufizuar, me çmim 25 denarë për një orë.





# PARKINGJE TË REJA TË QYTETIT

## PARA KOPSHTIT ZOOLOGJIK

Para objektit të Kopshtit zoologjik, nga ana e djathtë e bulevardit "Ilinden", ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan parking për 93 automjete. Parkingu është rrethuar me brez të

gjelbër prej 10 metrash dhe është ndriçuar.

Qyteti i Shkupit për këtë projekt ndau rreth 10 milion denarë.



## TEK QT „MAVROVKA“

Parkim zonal është vendosur edhe në parkingun me 110 vende, prapa qendrës tregtare „Mavrovka“, gjë me të cilën u zvogëluar në mënyrë të ndjeshme kaosi në qarkullimin rrugor që krijohet në këtë vend me frekuencë të madhe, kurse qytetarëve u mundësoi që të vijnë më lehtë deri në vend parkimi.

## PARA GODINËS SË RTVM



Në vitin 2010 u rregullua hapësira-parking para godinës së Radiotelevizionit të Maqedonisë, ku është vendosur parkimi zonal. Parkimi shtrihet

në një sipërfaqe prej 2 800 metra katror dhe siguron hapësirë-parking për 130 automjete.

Qyteti i Shkupit për rregullimin e

këtij parking nga Buxheti ndau rreth 3,5 milion denarë.

## U RRIT NUMRI I VENDEVE TË PARKIMIT NË AERODROM

Qyteti i Shkupit ndau 5 milion denarë për ndërtimin e parkingut në rrugën "Vasko Karan-gelevski", në lagjen Aerodrom. Lokacioni siguron vend-parkimi për 220 automjete.

Punët ndërtimore në këtë parking i përfundoi ndërmarrja publike „Rrugë dhe rrugica”.



Në lagjen Aerodrom në dy vitet e fundit janë ndërtuar dhe zgjeruar shumë parkingje gjë me të cilën janë formuar 462 vende parkimi të reja, në këto lokacione:

- në bulevardin "Jane Sandanski" (përballë objektit „Mek-donalds”) - 80 vende parkimi të reja
- në bulevardin "Jane Sandanski" (përballë super markatës „Vero”) - 38 vende parkimi të reja

- në bulevardin "Jane Sandanski" (tek QT „Biser”) - 46 vende të reja parkimi

- në bulevardin "AVNOJ" (përballë sallës sportive „Jane Sandanski”) - 166 vende parkimi të reja

- në bulevardin "ASNOM" (përballë parkut „Aerodrom”) - 132 vende parkimi të reja. Në këtë pjesë në vijim është shënimi i 112 vendeve të parkimit.



# DY PARKINGJE TË REJA NËN QENDRËN TRANSPORTUESE

Nën Qendrën transportuese është hapur parking për automjete të lehta motorike me sipërfaqe 6 840 metra katror dhe 218 vende të shënuara për parkim.

Me parkingun menaxhon NP „Parking u i qytetit“, kurse për ndërtimin dhe rregullimin e hapësirës Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 12 milion denarë.

•

Qyteti i Shkupit në vitin 2011 përfundoi ndërtimin e parkingut për autobusë, furgon dhe për mjete të lehta motorike nën Qendrën transportuese. Parking u i ri siguron 64 vende për parkim, dhe atë 10 vende për autobusë, 12 për automjete-furgon dhe 42 vende për automobila.

Në këtë projekt Qyteti investoi rreth 11,6 milion denarë.



# 445 VENDE PARKIMI NË GARAZHIN NË RRUGËN “SVETI KIRIL I METODIJ”...



Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 656 milion denarë për ndërtimin e garazhit me kate në rrugën “Sveti Kiril i Metodij”. Objekti i ri do të ketë dy kate nën tokë dhe shtatë kate mbi tokë. Në të


do të ketë 445 vende parkimi, nga të cilat 17 vende për parkim do të jenë për personat me nevoja të veçanta.

Garazhi duhet të jetë gati në vitin 2013.





# ... 605 VENDE PARKIMI NË GARAZHIN NË RRUGËN “DAME GRUEV”



Në vijim është ndërtimi i garazhit me kate në rrugën “Dame Gruev”. Ky projekt do të ketë 7 kate mbi tokë dhe dy nivele nën tokë. Do të sigurojë vende parkimi për 605 automobila.

Garazhi me kate në rrugën “Dame Gruev” pritet të ndërtohet për dy vjet. Në këtë objekt kapital Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 850 milion denarë.





## NË SHUTO ORIZARE

Në vitin 2009 u lëshua në përdorim instalimi i ri hidrofor me të cilin u përmirësua furnizimi me ujë të pijshëm në një pjesë të lagjes Shuto Orizare.

Sistemi i ri i hidroforit, me tubacion nën presion, zgjidhi problemin shumëvjeçar të qytetarëve në komunën Shuto Orizare. Projekti me vlerë rreth 5 milion denarë është financuar nga Qyteti i Shkupit, NP "Ujësjellës dhe kanalizim", komuna Shuto Orizare dhe nga Ministria për transport dhe lidhje.

# PO NDËRTOHET

# RRJETI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM

## NË KOMUNËN BUTEL

Ndërtimi i rezervuarit për ujë të pijshëm me tubacion përcjellës për vendet e banimit Kuçevishka Bara dhe Bel Kamen po zhvillohet sipas dinamikës së parashikuar. Në terren do të ndërtohet rezervuar për ujë me vëllim 500 metra kub, tubacion përcjellës deri në rezervuarin me gjatësi 650 metra, një pusetë për ventil për lëshimin e ujit dhe një pusetë për ventil ajri. Në fund të punëve ndërtimore të sistemit të ujësjellësit do të ndërtohet edhe korsia hyrëse deri te rezervuari.

Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Komunës së Butelit, kurse sipas kontratës për bashkëpunimin ndërmjet komunave, me vlerë të përgjithshme prej 13 milion denarë, Qyteti i Shkupit merr pjesë me 8 milion denarë.

Pas ndërtimit të sistemit, ai do t'i jepet në përdorim NP „Ujësjellës dhe kanalizim“.



Rezervuar për ujë për Kuçevishka Bara



## NË KOMUNËN AERODROM

Ekipet e Qytetit të Shkupit rinovuan 1 800 metra të rrjetit të ujësjellësit në rrugët "Gornovranovska" dhe "Bozhin Nikollov", në lagjen Gorno Lisiçe.

Qëllimi i këtij projekti ishte që të përfundohej rikonstruksi-  
oni i plotë i rrjetit të ujësjellësit në këtë pjesë të qytetit, kurse tubat  
ekzistues të zëvendësohen me tuba me profil më të madh.



Ujësjellës i ri në Gorno Lisiçe

## NË KOMUNËN KARPOSH

Është rinovuar edhe rrjeti i ujësjellësit në rrugën  
"Demir Trajko". Janë vendosur tuba të reja me gjatësi 584  
metra dhe janë zëvendësuar me 31 lidhje përcjellëse deri  
afër shtëpive në këtë rrugë.



Rrjeti i ri ujësjellësi për rrugën "Pero Nakov"

Rrjeti i ri ndërtuar i ujësjellësit në rrugën "Pero Nakov", në  
komunën e Gazi Babës, përmirësoi furnizimin me ujë të pijshëm  
të 30 000 banorëve të lagjeve Maxhari, Hipodrom, Çento dhe  
zonën lindore industriale.

Rrjeti është i gjatë 656 metra. Për ndërtimin e tij janë  
shpenzuar rreth 19 milion denarë.

## NË GAZI BABA

Rrjeti sekondar i ujësjellësit në  
vendbanimin Kamnik  
u lëshua në përdorim  
në vitin 2009. Me këtë  
u zgjidhën proble-  
met shumëvjeçare me  
furnizimin me ujë të  
pijshëm të më shumë  
se 2 500 banorëve të  
lagjes Kamnik.







Kanalizim atmosferik në BV "Bajram Shabani"

Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në bashkësinë vendore „Bajram Shabani“, komuna e Çairit, është në fazën përfundimtare. Ky projekt realizohet në dy pjesë. Në pjesën e parë ndërtohet dega 2 e këtij kanalizimi atmosferik me gjatësi 810 metra i cili lidh kolektorin ekzistues Ø 1900 mm në rrugën “Cvetan Dimov”.

Për ndërtimin e degës 2 të këtij kanalizimi atmosferik Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 8,4 milion denarë.

Në pjesën e dytë po ndërtohen degët 3, 4 dhe 5 me gjatësi të përgjithshme rreth një kilometër. Për fazën e dytë të ndërtimit të kanalizimit atmosferik në bashkësinë vendore „Bajram Shabani“ Qyteti i Shkupit do të investojë 6 milion denarë.

# PËRMIRËSOHET KANALIZIMI ATMOSFERIK

Bulevardi “Hristijan Todorovski Karposh” në lagjen Butel u bë me kanalizim atmosferik me gjatësi 547 metra. Rrjeti do të zgjidhë përgjithmonë problemet me përcjelljen e ujërave nga reshjet dhe përmytjet e rrugës pas shirave të rrëmbyeshëm.

•

Kanalizimi atmosferik në bulevardin “Serbia”, tek fabrika e çimentos „Usje“ u lëshua në përdorim në vitin 2009. Kanalizimi atmosferik në këtë drejtim është i gjatë 560 metra dhe zvogëloi në mënyrë të ndjeshme problemet me të cilat ballafaqoheshin rreth 7 000 banorë gjatë çdo shiu të rrëmbyeshëm.

Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi 8 milion denarë.



Rrjet kanalizimi atmosferik në bulevardin "Hristijan Todorovski Karposh"



Është ndërtuar plot-  
ësisht kolektori që mbledh  
ujërat atmosferik nga lagjja  
Qeramidnica, si dhe ujërat  
nga kryqëzimi tek hoteli „Kon-  
tinental“ deri në derdhjen e  
lumit Vardar, me gjatësi 530  
metra. Për këtë projekt Qyteti  
i Shkupit ndau 26 milion de-  
narë.

•

Me projektin e  
përbashkët Qyteti i Shkupit,  
komuna Gazi Baba dhe Mi-  
nistria e transportit dhe lid-  
hjeve ndërtuan kanalizimin  
atmosferik dhe të ujërave të  
zeza të rrugës “Juzhnomo-  
ravski brigadi”. Projekti është  
me vlerë 23 milion denarë.



Kanalizim atmosferik në Qeramidnica



Rrjet atmosferik në bulevardin  
"Makedonska vojska"

Ekipe e Qytetit  
të Shkupit vendosën  
kanalizimin atmosf-  
erik edhe nëpër trasenë  
e pjesës së dytë të bu-  
levardit “Makedonska  
vojska”, drejt lumit Var-  
dar. Kanalizimi është i  
gjatë 974 metra, kalon  
nën rrugën automobi-  
listike në bulevardin  
e ri të ndërtuar, në dy  
pjesë, nga kryqëzimi  
me bulevardin “Ma-  
kedonska vojska” me  
rrugët “Gjorçe Petrov”  
deri në derdhjen në lu-  
min Vardar dhe stadiu-  
mi Gjorçe Petrov deri  
në derdhjen e lumit  
Vardar.



# U RINOVUA RRJETI I KANALIZIMIT

## STACION RIPOMPIMI NË LAGJEN GORNO LISIÇE



Si investim i përbashkët i Qytetit të Shkupit, komunës Aerodrom dhe Ministrisë së transportit dhe lidhjeve është ndërtuar stacioni ripompimi për përfshirjen e ujërave të zeza në bregun e djathtë të lumit Vardar. Në vlerën e përgjithshme të këtij projekti prej 48 milion denarë Qyteti i Shkupit mori pjesë me 21 milion denarë.

Stacioni i ripompimit pompon direkt dhe i përcjell të gjitha ujërat e zeza nga lagja Gorno Lisiçe, Lisiçe, Novo Lisiçe, Aerodrom dhe nga lagja "11 Oktomvri", komuna Kisela Voda.

## DY MILION EURO PËR KOLEKTORIN FEKAL NË LISIÇE

Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 2 milion euro për ndërtimin e kolektorit fekal në lagjen Lisiçe, me ndërtimin e së cilës rreth 100 000 banorë të Shkupit u bënë me sistem përcjellës me kualitet, kurse gropat septike bëhen pjesë e historisë. Ky është një nga projektet më të mëdha në Shkup nga fusha e infrastrukturës nëntokësore.

Gjatësia e përgjithshme e kolektorit të ndërtuar është 2080 metra.



Në maj të këtij viti u lëshua në përdorim edhe kanalizimi i ujërave të zeza me stacionin e ripompimit për vendbanimet Singeliq - Ekonomija - Inxhikovë. Në vlerën e përgjithshme të projektit prej 35 milion denarë Qyteti i Shkupit investoi 15 milion denarë, Ministria për ambientin jetësor planifikimin hapësinor 10 milion denarë, kurse komuna Gazi Baba - 10 milion denarë.

Ndërtimi i kësaj dege të kanalizimit primar të ujërave të zeza siguroi përcjelljen e ujërave të zeza në vendbanimin Ekonomija dhe nga pjesë të Singeliq, Stajkovci dhe Inxhikovë, nga rreth 1 000 amvisëri.





Kolektor për lagjet Stajkovci, Çento, Inxhikovë

Kolektori i ujërave të zeza dhe atmosferike për lagjet Stajkovci, Çento, Inxhikovë, Hipodrom dhe Maxhari, si dhe stacioni i ripompimit për ujërat e zeza „Makoshped“ në fund të vitit 2009 u ndërtuan plotësisht dhe u lëshuan në përdorim.

Sistemi i kolektorit zgjidhi problemet shumëvjeçare të rreth 30 000 banorëve. Ndërtimi i sistemit të kolektorit dhe rikonstruksioni i stacionit të ripompimit kushtuan 120 milion denarë, nga të cilat 61 milion denarë siguroi Qeveria e Republikës së Maqedonisë, kurse mjetet e tjera i siguroi NP „Ujësjellës dhe kanalizim“.

•

Përfundoi ndërtimi i fazës së tretë të kanalizimit atmosferik në fshatin Ljubanci . Me këtë punë ndërtimore fshati Ljubanci plotësisht u lidh me kanalizimin e ujërave të zeza.

Në terren u ndërtuan tre degë të kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Ljubanci, me gjatësi të përgjithshme 857 metra. Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunës së Butelit. Në projektin me vlerë rreth 6,3 milion denarë Qyteti i Shkupit mori pjesë me rreth 5 milion denarë.



Ekipe e Qytetit të Shkupit ndërtuan plotësisht kanalizimin e ri të ujërave të zeza në bulevardin e ri të projektuar „AS-NOM“ në Gorno Lisiçe, me gjatësi 1 200 metra. Për këtë projekt janë ndarë 18 milion denarë, para nga buxheti i Qytetit të Shkupit.



Rrjet kanalizimi i ujërave të zeza



# PËR SIGURI MË TË MADHE NË QARKULLIMIN RRUGOR



## BREZ I GJELBËR NË BULEVARDIN “PARTIZANSKI ODREDI”

Përgjatë bulevardit “Partizanski odredi”, nga kryqëzimi me rrugën “Aco Shopov” në Vllae deri në kryqëzimin me rrugën “Vasil Glavinov” në qendrën e qytetit, Qyteti i Shkupit vendosi brez të gjelbër për lëvizjen e automjeteve. Gjatësia e përgjithshme e bulevardit “Partizanski odredi” në të cilin është vendosur

brezi i gjelbër i lëvizjes është i gjatë 5.126 metra.

Vendosja e brezit të gjelbër u mundëson qytetarëve me shpejtësi mesatare 50 kilometra në orë me automjetet e tyre të kalojnë nëpër bulevardin “Partizanski odredi” pa u ndalur në semaforë. Me brezin e gjelbër janë përfshirë 9 kry-

qëzime ekzistuese semafori dhe 6 kalime të reja për këmbësorë të semaforizuar.

Gjashtë kalimet e reja përgjatë bulevardit “Partizanski odredi” i realizuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“, kurse për këtë punë ndërtimore Qyteti i Shkupit ndau 6,5 milion denarë.



Qyteti i Shkupit filloi aksionin për shënimin natën të sinjalizimit horizontal në rrugët e qytetit. Shënimi i rrugëve kryhet nga ora 23 deri në orën 5 të mëngjesit.

Qëllimi i aksionit është freskimi i rregullt i sinjalizimit, dhe gjatë kësaj kohe të mos krijohet kaos plotësues nëpër rrugët e qytetit.





Qyteti i Shkupit katër e vitet e kaluara në shumë rrugë automobilistike të qytetit vendosi 1 834 shenja të reja rrugore, një pjesë e tyre si zëvendësim për të vjetrat.

Me modernizimin e qarkullimit rrugor, në vitin 2011 në Shkup për herë të parë u vendos shenja „Mos blloko kryqëzimin“, me të cilën rregullohet qarkullimi i automjeteve në kryqëzimin turbo rrethor në bulevardin „Mitropolit Teodosij Gologanov“. Kjo shenjë është kombinuar me shënimin horizontal rrjetor të kryqëzimit.



Në rrugët automobilistike të qytetit janë vendosur 656 lanterë të tjerë semaforik. Përveç rinovimit të semaforëve të vjetër u formuan edhe 11 kryqëzime të reja.

Në të gjitha kryqëzimet në Ringun e vogël dhe të madh të qytetit janë vendosur numërat në semaforë.

## QENDRA PËR MENAXHIMIN DHE KONTROLLIN E KOMUNIKACIONIT RRUGOR

Në suazat e zhvillimit të koncepteve të reja për qarkullim rrugor efikas, Shkupi filloi realizimin e projektit Qendra për menaxhimin dhe kontrollin e qarkullimit rrugor (QMKK). Qendra është vendi nga i cili me zbatimin e teknologjive informatike dhe arritjeve më të reja të teknologjisë mundësohet menaxhimi dhe kontrolli i qarkullimit rrugor në kohë reale, në varësi të ngarkesës së qarkullimit rrugor.

Funksionet kryesore të QMKK-së do të jenë: grumbullimi i të dhënave për qarkullimin rrugor në kohë reale, menaxhimi me sistemin e semaforëve, mbikëqyrja e qarkullimit rrugor, dhënia e prioritetit për automjetet e transportit publik dhe automjeteve me prioritet (ndihma e shpejtë, zjarrfikëse, policia), drejtimin nga vende të lira për parkim, dërgimi i informacioneve për qarkullimin rrugor nëpërmjet shenjave me përmbajtje të ndryshueshme, menaxhimi me zona të ndaluara për qarkullim rrugor etj. Ndërtimi dhe pajisja e Qendrës për menaxhimin dhe kontrollin e qarkullimit rrugor do të kushtojë rreth 160 milion denarë.



Që të mbrohen rrugët automobilistike nga ngarkesat e kamionëve të rëndë në ditët e nxehta të verës Qyteti i Shkupit për herë të parë vendosi ndalim qarkullimi për kamionët e rëndë nëpër rrugët e qytetit. Ndërmarrja publike "Rrugë dhe rrugica" për këtë qëllim vendosi 142 shenja për ndalim qarkullimi, kurse në koordinim me Ministrinë e punëve të brendshme u realizuan masa ndëshkuese.

# U UNIFIKUA TRANSPORTI - TAKSI



Tabela dhe shenja të reja për taksistët e licencuar

Automjetet transportuese taksi kanë pamje të unifikuar në shënimin e jashtëm dhe në brendësinë e tyre. Çdo automjet ka tabelë të unifikuar me mbishkrimin TAK-

SI dhe numrin e certifikatës të licencës, të dhënë nga Qyteti i Shkupit.

Unifikimi i pamjes së automjeteve taksi kontribuoi që t'i vihet fund kaosit

shumëvjeçar në transportim taksi, gjë me të cilën u përmirësua kualiteti i shërbimeve, siguria e udhëtarëve, si dhe kushtet për punë të transportuesve taksi.

## U MORËN 70 AUTOMJETE NGA TRANSPORTUESIT JOLEGAL AUTO-TAKSI

Qyteti i Shkupit përkohësisht mori 70 automjete motorike të transportuesve taksi jolegal, në përputhje me masën e re marrjen e përkohshme të automjeteve të sjellë me ndryshimin e Ligjit për transport në qarkulli-

min rrugor. Kundër të gjithë shkelësve, përveç masës së shqiptuar për marrjen e përkohshme të automjeteve, janë dorëzuar edhe kallëzime adekuate kundërvajtjeje. Gjopa për kryerjen jolegale të veprimtarisë auto-taksi është

500 euro në kundërvlerë në denarë. Inspektorët e qytetit këtë masë e realizojnë në bashkëpunime me MPB-në dhe me Agjencinë për menaxhimin me pronën e marrë.



Ekipet e Qytetit të Shkupit rregulluan 75 stacione auto-taksi, gjë me të cilën janë siguruar kushte për stacionimin e rreth 450 automjeteve taksi.



# LËRE AUTOMOBILIN, NGIT BIÇIKLETËN



Qytetarët e Shkupit mund të huazojnë biçikleta për 10 denarë në orë në katër lokacione në qytet – në parkingun publik „Treska“, parkingun publik tek sheshi „Maqedonia“, dhe në lagjen Aerodrom, tek Qendra tregtare „Biser“. Me kërkesë të shfrytëzuesve, në vijim janë përgatitjet për hapjen e punktimit për huazimin e

biçikletave edhe tek Kopshti zoologjik.

Projekti për huazimin e biçikletave realizohet nën moton „Lëre automobilin, ngit biçikletën“, për të tretin vit me radhë.

Qyteti i Shkupit në tre vitet e fundit punoi në mënyrë aktive në promocionin e biçikletës si mjet transporti alternativ dhe rekreativ. Pikërisht për këtë, me ngjyrë të kuqe janë shënuar një numër i madh korsish për biçikleta, është vendosur lidhje e korsive të biçikletave nëpër bregun e lumit Vardar, është rinovuar dhe sinjalizim i ri plotësues horizontal dhe vertikal dhe janë vendosur vende parkimi për biçikleta në shumë lokacione nëpër qytet.



Qyteti i Shkupit porositi studim për model optimal për organizimin e sistemit për transportin e udhëtarëve në territorin e Qytetit të Shkupit. Qëllimi i këtij studimi është që të bëhet model plotësisht i ri për transportin publik me të cilin do të sigurohen kushte më të mira për transportin e udhëtarëve.

Qyteti i Shkupit, si donacion nga ministria e transportit dhe lidhjeve, mori studim për modelin e transportit. Me këtë studim bëhet analiza e karakteristikave të rrjetit të qarkullimit rrugor në kontekstin e zhvillimit të qarkullimit rrugor në kryeqytet 10-20 vitet e ardhshme, dhe ofrohen zgjidhje në cilat drejtime të lëvizë transporti rrugor.



# NP „DRISLA“



Nga fundi i vitit 2009, me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit depoja „Drisla“ u nda nga NP „Higjiena komunale“ si subjekt juridik i veçantë. Me vendim të Këshillit, u formua Ndërmarrja publike për deponimin e mbeturinave komunale „Drisla“ – Shkup.

Arsyeja për formimin e ndërmarrjes publike të veçantë është nevoja për deponimin dhe përpunimin e mbeturinave sipas standardeve evropiane dhe botërore, gjë me të cilën Shkupi do të ketë depo sanitare moderne.

## IU DHA FUND NDOTJES SË LUMIT MARKOVA REKA

Qyteti i Shkupit në 4 vitet e fundit investoi rreth 25 milion denarë për kaptimin e burimit në depon „Drisla“, stabilizimin e sheshit dhe hyrjeve për trajtimin e kullimeve, realizimin e stabilizimit të pjerrësive të rrjedhjes së ujit, asfaltimin e rrugës në lokalitetin Drisla, ndërtimin

e platformës për makineritë e ndërtimit, pompën për trajtimin e kullimeve nga depoja dhe për peshoren e re elektronike të automjeteve për matjen e mbeturinave.

Me modernizimin e ndërmarrjes publike „Drisla“, që nënkupton trajtimin

bashkëkohor të mbeturinave, ujërave të zeza, seleksionimin e mbeturinave, dëgjien dhe trajtimin e gazrave që çlirohen gjatë shpërbërjes së mbeturinave, u mundësua mbrojtja më e mire e ambientit jetësor dhe iu dha fund erës së keqe dhe ndotjes së Markova reka.







Qyteti i Shkupit dhe NP „Drisla“ blenë shtatë automjete të përdorura që në mënyrë të ndjeshme përmirësuan punën e kësaj ndërmarrje publike. Janë blerë 2 buldozerë, kompaktor për punën e depos, eskavator, 2 kamionë dhe çisternë për ujë. Vlera e përgjithshme e pajisjeve është rreth 40 milion denarë.

Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të ndërmarrjes publike „Rrugë dhe rru-gica“ ndërtojnë vende të reja për vendosjen e kontejnerëve në rrugët e qytetit. Qyteti i Shkupit do të ndërtojë 121 vende për vendosjen e kontejnerëve me vëllim 1,1 metër kub.

Si pjesë e përpjekjeve të Qytetit të Shkupit për qytet më të pastër dhe ngritjen më efikase të mbeturinave të mbledhura, qyteti i Shkupit vendosi 116 kontejnerë teli me tre dhoma për mbledhjen e seleksionuar të plastikës, letrës dhe kanoçeve. Kontejnerët janë shpërndarë në të dhjetë komunat e Shkupit. Me këtë u krijuan kushte që qytetarët e Shkupit nga paketimet e amvisërive të tyre të seleksionojnë dhe dërgojnë në kontejnerin përkatës të vendosur në lokacion më të afërt.



Në shumë lokacione nëpër qytet janë vendosur 1 300 kontejnerë të rinj dhe 4 500 kazanë për mbeturina me kapacitet 120 litra, si donacion për Qytetin e Shkupit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.



Amvisërive individuale në Shkup ju janë ndarë falas 60 000 kazanë plastik për mbeturina. Vlera e këtij projekti është rreth 900 mijë euro, para të siguruar si kredi nga Banka botërore, me ndihmën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

# NP „HIGJIENA KOMUNALE“



Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ nga fundi i vitit 2009 u pajis me gjashtë automjete të reja të specializuara për grumbullimin e mbeturinave. Kamionët e rinj janë me kapacitet 16 metra kub, me mekanizëm për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve standardë me kapacitet 1,1 kubik dhe kazanë nga 120 deri në 240 litra.

Në blerjen e automjeteve të reja Qyteti i Shkupit mori pjesë me rreth 16 milion denarë.

Qyteti i Shkupit në vitin 2010 bleu gjashtë automjete të reja të specializuara për grumbullimin e mbeturinave për nevojat e NP „Higjiena komunale“. Kamionët e rinj me vëllim 20 metra kub, me sistem për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve me kapacitet 1,1 metra kub dhe kazanë me vëllim 120 litra.

Çmimi i gjashtë automjeteve është rreth 50 milion denarë.

Mbeturinat nga lagjet Draçevë, Pintija, Usje dhe Pripor grumbullohen me dy automjete që i bleu komuna Kisela Voda dhe ia dhuroi NP „Higjiena komunale“.



Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ në vitin 2011 u pajis me 23 automjete të reja të specializuara për grumbullimin e mbeturinave. Për blerjen e gjashtë automjeteve të para të specializuara Qyteti i Shkupit i ndau NP „Higjiena komunale“ mjete të destinuara në vlerë prej 30,5 milion denarë. Për blerjen, e 17 automjeteve për nevojat e ndërmarrjes mjetet në vlerë prej rreth 110 milion denarë janë siguruar me kredi të Republikës së Maqedonisë nga Banka botërore në suazat e „Projekti për përmirësimin e shërbimeve komunale“, si nën-hua e Qytetit të Shkupit.

Për ngritjen e mbeturinave nga rrugicat e ngushta në qytet NP „Higjiena komunale“ këtë vit me mjetet e veta bleu 5 automjete të vegjël me kapacitet plotësues 5 metra kub.

Kanë arritur edhe 10 automjete të vogla për ngritjen e mbeturinave nga kazanët individual me vëllim 120 litra.



Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ këtë vit u rinovua me dy automjete të reja të specializuara për pastrimin e rrugëve automobilistike – fshesa dhe me 5 kamionë të vegjël për grumbullimin e mbeturinave. Për blerjen e këtyre automjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit janë ndarë rreth 18 milion denarë. Kamionët e vegjël për grumbullimin e mbeturinave nga rrugicat e ngushta, përkatësisht nga lagjet ku kamionët e mëdhenj nuk mund të hyjnë për shkak të konfiguracionit të terrenit, janë me kapacitet prej 5 metra kub, me sistem për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve ose në të njëjtën kohë ngritjen dhe zbrazjen e 2 kazanëve me nga 120 litra.

Pesë kamionët e vegjël për grumbullimin e mbeturinave ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ i bleu me mjetet e veta.



Qyteti i Shkupit, NP „Higjiena komunale“ dhe komuna Qendër do të investojnë rreth 30 milion denarë për ndërtimin e kontejnerëve nëntokësor për mbeturina të përziera dhe të seleksionuara, në 15 lokacione në qytet.

Grumbulluesit joformal të mbeturinave të seleksionuara nënshkruan kontratë dhe u bënë pjesë e integruar e sistemit të NP „Higjiena komunale“ për seleksionimin dhe përpunimin e mbeturinave nga paketimet, që u jep njohje juridike për aktivitetet e tyre. Dymbëdhjetë grumbullues joformal mbledhin mbeturinat e seleksionuara nga territori i komunave Gjoçe Petrov, Karposh dhe Qendër. Mbeturinat e grumbulluara në oborrin e riciklimit në bulevardin „Ilinden“ i blen NP „Higjiena komunale“, i paketon dhe siguron plasman si lëndë e dytë nëpërmjet „Pakomak“.



Kapaciteti i stacionarit „Vardarishte“ është rritur dyfish. Objekti është ndërtuar sipas standardeve evropiane dhe në të janë rregulluar 48 bokse të reja për akomodimin dhe trajtimin human të qenve endacakë të kapur.

Për zgjerimin e stacionarit „Vardarishte“ Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 7 milion denarë.



Për nevojat e NP „Higjiena komunale“ Qyteti i Shkupit në korrik të viti 2011 bleu rimorkio për transportin e gjedhëve. Rimorkioja shfrytëzohet për transportin e kuajve të cilët do të kapen në sipërfaqet e gjelbra nëpër qytet.

Për blerjen e rimorkios Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 298 965 denarë.



# NP „UJËSJELLËS DHE KANALIZIM“

Në vitin 2009 ekipet e NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ filluan të vendosin tip të ri ujëmatësi me lexim në largësi në amvisëritë e Shkupit. Ky projekt i Qytetit të Shkupit dhe NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ lehtëson leximin e ujëmatësve, zvogëlon kohën e leximit dhe njofton për defektet e rrjetit në shtëpitë e qytetarëve për të penguar rrjedhjen e panevojshme të ujit.



Automjeti special i NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ nga viti i kaluar zbulon defektet në rrjetin e ujësjellësit në qytet. Automjeti, i cili është pajisur me të gjitha standardet më bashkëkohore dhe është i vetmi i këtij lloji në regjion, kontribuoi për zvogëlimin e humbjeve të ujit në sistem.

Për blerjen e këtij automjeti NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ ndau 7,5 milion denarë.



# NP „RRUGË DHE RRUGICA“



Në vitin 2011 u rinovua baza e asfaltit të NP „Rrugë dhe rrugica“ që gjendet në oborrin e fabrikës „Hekurana“ në Butel.

Baza e asfaltit është automatizuar plotësisht, prodhimi kontrollohet nëpërmjet sistemit kompjuterik, dhe është zgjidhur problemi me ndotjen e ajrit nëpërmjet filtrave të ajrit. Me rikonstruktionin e bazës ndërmarrja publike përmirësoi efikasitetin në punë, përmirësoi kualitetin e asfaltit dhe kohën për përgatitjen e tij, kurse do të zvogëlohet mundësia nga defektet.

Për rikonstruktionin e kësaj baze Qyteti i Shkupit investoi 15 milion denarë.

Për të rritur kualitetin e shënimit të sinjalizimit horizontal të rrugëve e qytetit dhe që të shkurtohet koha e punës, NP „Rrugë dhe rrugica“ mori makinë të re. Automjeti është me kapacitet më të madh dhe me rezervuar për bojë prej 150 litra.

Shfrytëzimi i makinës së re mundësoi të krijohet qëndrim më i vogël në qarullim në periudhën kur freskohet sinjalizimi horizontal në rrugët automobilistike.





# NQP „SHKUP“

Në rrugët e qytetit qarkullojnë 216 autobusë të rinj të Ndërmarrjes së qarkullimit publik „Shkup“, nga të cilët 136 autobusë dykatësh nga Kina dhe 80 autobusë me dysheme të ulët nga Ukraina. Me lëshimin në qarkullim të autobusëve të rinj është ri-

novuar 70 % e parkut të automjeteve të kësaj ndërmarrje publike.

Autobusët e rinj janë përgatitur sipas teknologjive më moderne dhe janë pajisur me informatorë të jashtëm dhe të brendshëm, kondicionerë, platforma për persona me ne-

voja të veçanta, si dhe motorë ekologjikë të cilët do të sigurojnë ndotje më të vogël të ajrit dhe shpenzim më të vogël të karburantit. Me blerjen e autobusëve të rinj u zgjidhën problemet shumëvjeçare në transportin publik, kurse qytetarët e Shkupit me kënaqësi shfrytëzojnë transportin publik të autobusëve.

Projekti për rinovimin e parkut të automjeteve të NQP „Shkup“ është rezultat i bashkëpunimit të mirë të Qytetit të Shkupit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.



Këtë vit u rinovua salla e Ndërmarrjes së qarkullimit publik „Shkup“ në Gjorçe Petrov. Objekti është riadaptuar në një qendër

shërbimi moderne për autobusët, me kapacitet për të shërbyer në të njëjtën kohë më së paku 5 autobusë njësh dhe 3 autobusë fizarmonikë. Që të kryhet servisimi i autobusëve dykatësh është rritur lartësia e objektit.

Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 15 milion denarë.



Janë blerë edhe 16 minibusë që do të qarkullojnë në linjat ndërrbane të autobusëve.





Të gjithë qytetarët e interesuar nga kjo verë do të kenë mundësi t'i shikojnë monumetet kulturore-historike të qytetit në autobusin e ri panoramik dykatësh i cili qarkullon dy herë në ditë, në orën 11 dhe në orën 17, duke u nisur nga Porta "Makedonia".



Mbi pesëqind mijë qytetarë kanë hipur deri tani në Kryqin e mijëvjeçarit në Vodno me teleferikun e ri. Teleferiku disponon me 28 kabina për tetë persona dhe dy VIP kabina për katër persona. Qeveria e Republikës së Maqedonisë për ndërtimin e teleferikut ndau rreth 8 milion euro. Teleferikun në Vodno e ndërtoi firma austriake „Doppelmaier“, kurse me të menaxhon Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“.

Në katër vitet e fundit NQP vendosi 15 linja të reja urbane dhe ndërrbane të autobusëve, ndërmjet të cilave dhe 3B, 22A, 57A, 26, 15A, linja Kryqi i mijëvjeçarit (nga Qendra transportuese deri në Vodnon e mesme), 42 dhe 32.

Personat e moshuar kanë mundësi të udhëtojnë falas në autobusët e NQP-së të martën dhe të premten. Mundësia për transport falas ka të bëjë me qytetarët e moshuar, më saktë për burra që kanë mbushur 64 vjet dhe gra që kanë mbushur 62 vjet.





Brigada për mbrojtjen kundër zjarrit e Qytetit të Shkupit në vitin 2011 mori tre automjete të reja zjarrfikëse për shuarjen e zjarreve në ambiente urbane. Një automjet zjarrfikës është blerë nga Qyteti i Shkupit, kurse dy automjete zjarrfikëse janë donacion i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Qyteti i Shkupit për blerjen e automjeteve zjarrfikëse nga buxheti ndau rreth 13 600 000 denarë. Tre automjetet për shuarjen e zjarreve përmirësuan kapacitetet e Brigadës për mbrojtjen kundër zjarreve dhe lehtësuan punën e zjarrfikëseve të Shkupit.

# BRIGADA PËR MBROJTJEN KUNDËR ZJARREVE



Dy barka shpëtimi me motor, kamera termike, dy automjete terreni, kapele mbrojtëse zjarrfikëse dhe doreza sipas standardeve evropiane dhe uniforma verore, bleu Qyteti i Shkupit për Brigadën për mbrojtjen kundër zjarreve në vitin 2010.

Gjatë vitit 2010 u rinovua një pjesë e nyjave sanitare në stacionin Autokomanda, u rinovua një pjesë e nënqendrës zjarrfikëse „Taftalixhe“, janë blerë pajisje kancelarie, mobilie dhe batanije për përmirësimin e kushteve akomoduese, si dhe pajisje informatike për nevojat e Brigadës.

Qyteti i Shkupit në vitin 2010 investoi rreth 20 milion denarë për blerjen e pajisjeve e pajisjeve të reja për Brigadën për mbrojtjen kundër zjarreve të Qytetit të Shkupit.

Brigada për mbrojtjen kundër zjarreve e Qytetit të Shkupit në vitin 2010 mori edhe 3 automjete të reja zjarrfikëse nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.





Brigada për mbrojtjen kundër zjarreve e Shkupit u bë edhe me kuadër të ri të trajnuar. Njëzetepesë zjarrfikës ndoqën dhe përfunduan trajnimin modular për profesionin e zjarrfikësit, që u mbajt në ambientet e SHMQSH „Marija Kyri Sklodovska“. Trajnimi përbëhej nga pjesa e përgjithshme teorike dhe pjesa teorike profesionale me trajnim praktik.

Këtë projekt e financoi plotësisht Qyteti i Shkupit.



Në vitin 2009 Brigada për mbrojtjen kundër zjarreve e Qytetit të Shkupit mori si donacion pajisje të përdorura zjarrfikëse nga qyteti i vëllazëruar Nyrenberg, RF e Gjermanisë. Bëhet fjalë për 120 aparate për frymëmarrje Dreger PA 80 në tryzni normale, 100 maska për frymëmarrje

je AUER3S, 30 aparate për frymëmarrje Dreger PA 94, 450 shishe çeliku për tryzni 300 bar, 80 shishe kompozite prej 6,9 litra në 300 bar, 4 karroca për transportin e tyre, 1 komplet për analizimin e kualitetit të ajrit, 300 aparate për paralajmërim se ekziston rrezik vdekjeje dhe pjesë rezervë

për aparatet e frymëmarrjes me mjet special dhe libër udhëzimesh.

Vlera e donacionit nga qyteti i Nyrenbergut është 300 000 euro.



Dita e zjarrfikësve – 20 maji u kremtua në stacionin zjarrfikës Autokomanda me roje nderi solemne të Brigadës për mbrojtjen kundër zjarreve dhe me realizimin e ushtrimeve taktike – treguese.

Në katër vitet e kaluara, në lokacione të ndryshme nëpër qytet, u vendosën 40 hidrantë sipërfaqësor për nevojat e brigadës zjarrfikëse.





Për të rritur efikasitetin në punën e NP „Parqe dhe gjelbërim“ në vitin 2011 u blenë tre makina shumëqëllimore, rajder për kositjen e barit, në të cilat mund të montohen mulçer, pjesë shtesë që përdoret për kositjen e barit të egër në të cilin ka kaçube ose bar të ashpër. Me një makinë të tillë për një ditë mund të kositet pjesa e parë e parkut të qytetit.

Është blerë kamion me platformë ngritëse për prerjen dhe krasitjen e drurëve me lartësi 13,5 metra dhe kamion me mekanizëm për ngarkim dhe shkarkim.

Qyteti i Shkupit për blerjen e këtyre pajisjeve të reja për NP „Parqe dhe gjelbërim“ nga Buxheti ndau 7,5 milion denarë.



## NP „PARQE DHE GJELBËRIM“



Në vitin 2011 Qyteti i Shkupit bleu 2 traktorë me rimorkio dhe makina lidhëse për kositjen e barit; 10 kositëse vetëlëvizës me kosha; 10 kositës bari manual me kosh dhe 14 trimerë gjë me të cilën u lehtësua puna e punëtorëve të NP „Parqe dhe gjelbërim“.

Për blerjen e pajisjeve të reja Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 3,5 milion denarë.



Pajisje të reja për mirëmbajtjen e gjelbërimit





Kamion vetëshkarkues dhe cisternë për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra

Një kamion vetëshkarkues dhe një cisternë për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe rreshtave të drurit në bulevarde në afërsi të të cilave nuk ka hidrantë për ujitje, për nevojat e NP „Parqe dhe gjelbërim“, bleu Qyteti i Shkupit në vitin 2010. Sipas nevojave, ky automjet mund të shfrytëzohet edhe për shuarjen e zjarreve eventuale në park–pyllin Vodno.

Për blerjen e dy automjeteve Qyteti i Shkupit ndau 5,8 milion denarë.

Paraprakisht, Qyteti i Shkupit për NP „Parqe dhe gjelbërim“ bleu edhe hapës kanalesh me platformë për krasitjen e degëve të larta.



Hapës kanalesh

Gjethet e rëna të mbledhura nga sipërfaqet e gjelbra transportohen deri në vendin e kompostimit në oborrin e NP „Parqe dhe gjelbërim“ ku deponohen për prodhimin e plehut organik – komposto. Plehu i prodhuar shfrytëzohet në prodhimin e luleve.





# PARK-PYLLI „VODNO“



Për ndriçimin e dy vend panoramave në Vodno janë vendosur llamba të reja me energji diellore. Në vend panoramën e parë janë vendosur 11, kurse në vend panoramën e dytë 13 llamba. Ndriçimi me llamba me energji diellore mundëson që të mos ketë shpenzime për energjinë elektrike.

Për ndriçimin e ri të vend panoramave në Vodno Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 2 milion denarë.

Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan korsi për këmbësorë me gjatësi 2 140 metra dhe gjerësi 2,2 metra përgjatë së cilës janë vendosur 4 stacione për këmbësorë me rekuizite fitnesi dhe tabelë informative për shfrytëzimin e rekuizitave. Korsa e këmbësorëve të çon nga Vodno e Mesme deri në Markovo Kruvçe.

Qyteti i Shkupit për ndërtimin e korsisë së këmbësorëve „Shkup“ ndau rreth 3 milion denarë.



Korsi për këmbësorë në Vodno

Pamje e re për vend-panoramat



Ekipet e Qytetit të Shkupit rinovuan dy vend panorama në Vodno. Hapësira është pastruar dhe pajisur me stola dhe kosha për mbeturina. Është rregulluar edhe rrethim mbrojtës i ri.



Në park-pyllin „Vodno“ katër vitet e fundit janë ndërtuar 19 vend panorama, dy pavione të mëdha, një kamp-primorkio, tre shtëpiza për alpinistë, një terren për fëmijë, 54 komplete tavolinash me stola dhe 88 kosha për mbeturina. Janë vendosur edhe tabela dhe portal informativ, dhe janë rinovuar edhe korsitë e alpinistëve.



Është rregulluar shtrati i përroit që rrjedh para sheshit të teleferikut dhe është ndërtuar kalim druri.

Në suazat e aktiviteteve të rregullta të Qytetit të Shkupit për mirëmbajtjen e gjelbërimit në park pyllin „Vodno“ katër vitet e fundit janë pyllëzuar 55 hektar me drurë halor dhe gjet-herënës.

Përfundoi projekti për shënimin hapësinor të kufijve të park pyllit „Vodno“ gjë për të cilën Qyteti i Shkupit investoi rreth 3,5 milion denarë.

Është përgatitur studimi për përcaktimin e vlerave natyrale dhe identifikimin hapësinor të kufijve të park pyllit „Vodno“ i cili është dërguar deri tek Ministria për ambientin jetësor dhe planifikimin hapësinor për rishpalljen e lokalitetit, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e natyrës.



Asfalti i vjetër dhe i dëmtuar në rrugën Vodno e mesme deri te manastiri „Shën. Pantelejmon“ në vitin 2009 u mënjana dhe u zëvendësua me shtresë të re asfalti. Rikonstruksioni i rrugës Vodno e mesme – Manastiri „Shën. Pantelejmon“ i kushtoi Qytetit Shkupit rreth katër milion denarë.



# PARK-PYLLI „GAZI BABA“



Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan korsi për këmbësorë me gjatësi 720 metra dhe gjerësi 1,90 metra përgjatë kufirit të park-pyllit „Gazi Baba“, nga parkingu tek Shtëpia e shëndetit „Hekurana“ deri te terreni sportiv për fëmijë. Për ndërtimin e saj Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth një milion denarë. Në park-pyllin „Gazi Baba“ është rregulluar korsa e këmbësorëve me gjatësi 3 kilometra.

Korsinë e këmbësorëve në park-pyllin „Gazi Baba“ ndriçuan 29 shtylla të reja dekorative për ndriçuan publik në lartësi

4,5 metra dhe llamba me fuqi 150 W, janë vendosur në gjatësi prej 680 metra. Ndriçimi i ri në këtë korsi që e vendosën ekipet e

Qytetit të Shkupit kontribuan për rritjen e sigurisë të qytetarëve.



Në park-pyllin „Gazi Baba“ në katër vitet e fundit janë ndërtuar 8 vend-panorama, dy kate ekologjike, shtëpizë për alpinistët, vend mbikëqyrës për mbrojtjen kundër zjarreve, 74 komplete tavolinash me stola dhe 113 kosha për mbeturina. Janë vendosur edhe 8 elementë rekreacioni dhe 4 tabela informative.





Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan korsinë për bicikleta për ciklizëm malor, terren për fëmijë dhe park për kanakarë në park-pyllin Gazi Baba.

Ekipet e Qytetit të Shkupit në park-pyllin „Gazi Baba” pyllëzuan 1,5 hektar me drurë gjetherënës, dhe janë mbjellur edhe 1 000 fidanë të mëdhenj në mënyrë plot-ësuese.

Është realizuar projekti për shënimin hapësinor në kufijtë e park-pyllit „Gazi Baba” gjë për të cilën Qyteti i Shkupit investoi rreth 1,3 milion denarë.



Në park-pyllin „Gazi Baba” është rregulluar korsa e këmbësorëve me gjatësi 3 kilometra. Përgjatë korsisë janë vendosur rekuizite të ndryshme sportive.

Është përgatitur Studim për përcaktimin e vlerave natyrale dhe identifikimin hapësinor të kufijve të lokalitetit „Gazi Baba” i cili është dërguar deri te Ministria për ambientin jetësor dhe planifikimin hapësinor për rishpalljen e lokalitetit, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e natyrës.



# NË KANIONIN E MATKËS




Ekipet e Qytetit të Shkupit rinovuan korsinë e këmbësorëve në kanionin e Matkës, nga kisha „Shën. Andrea“ deri në vendin quajtur Visok rid, me gjatësi 4 000 metra. Përgjatë korsisë është mon-

tuar rrethim mbrojtës i gjatë 600 metra, i përgatitur nga profile hekuri. Është rinovuar edhe vetë korsia me gurrë, kurse në disa vende janë kryer zgjerime për stola dhe për kosha për mbeturina.

Qyteti i Shkupit investoi 4 milion denarë në rikonstruksionin e përgjithshëm të korsisë së këmbësorëve dhe rrethimit mbrojtës.





Ekspedita evropiane e zhytësve të shpellave „Vrelo 2010“ e udhëhequr nga italianii Luixhi Kasati, arriti deri në thellësinë 212 metra në shpellën Vrelo dhe Matka. Kjo thellësi e arritur përbën rekordin e dytë për thellësi në Evropë, kurse të parin në Ballkan. Qyteti i Shkupit si sponsor kryesor i ekspeditës, përkrah këtë projekt me një milion denarë.



Sekretarja e Qytetit të Shkupit, Gordana Klinčarova në emër të Qytetit të Shkupit më 3 gusht u ndau mirënjohje speciale zhytësve me famë botërore Luixhi Kasati nga Italia dhe Maks van der Mulen nga Belgjika, për aktivitete të tyre shkencore hulumtuese në suazat e ekspeditës speleologjike në shpellën nënujore „Vrelo“, në Matka. Kasati dhe Van der Mulen udhëhoqën ekspeditën e këtij viti të përbërë nga profesionistë ndërkombëtarë për speleologji nga Belgjike, Franca dhe Italia, si dhe nga zhytësit maqedonas dhe anëtarë të shoqërisë speleologjike „Vrelo“, Kire Angeleski dhe Bojan Petkovski.

Këtë verë, Kasati dhe Van der Mule zbuluan dy galeri të reja nënujore, si dhe rrugë direkte në galerinë e parë nënujore, e cila në një masë të madhe do të shkurtojë rrugën e zhytjes në hulumtimet e ardhshme.




Ujërat e liqenit Matka dhe lumit Vardar në katër vitet e fundit u pasuruan me peshq, shumë herë me troftën endemike *Salmo macedonicus*. Me këto aksione Qyteti i Shkupit në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon mbi mbrojtjen dhe riprodhimin e troftës në ujërat e Maqedonisë.



Projekti për “Mbrojtjen e kështjellës Krshtallna në zonën e mbrojtur – Monumenti i natyrës kanioni Matka”, vendbanim i llojit lakuriqit të natës të kërcënuar në shkallë globale (*Miniopterus schreibersii*), zhvillohet sipas dinamikës së parashikuar. Me projektin parashikohen këto aktivitete: monitorimi i lakuriqëve të natës, përgatitja dhe botimi i Materialit edukativ, rrethimi i hyrjes në shpellën Krshtallna, përgatitja dhe vendosja e panove informative – paralajmëruese para hyrjes së shpellës, organizimi i tribunave publike dhe raport për aktivitete të realizuara të projektit.

Është vërtetuar që në shpellën Krshtallka ka 7 000 njësi të llojit lakuriqi i natës krahëgjatë. Projekti është financuar nga FGE (Fondi global ekologjik), Qyteti i Shkupit dhe Shoqëria speleologjike – Peoni.

# PAMJE MODERNE PËR KOPSHTIN ZOOLOGJIK



Pas 40 vjetësh Kopshti zoologjik këtë vjeshtë u bë me një gjirafë. Gjirafa, mashkulli i ri me emër Orka, është donacion nga Orka holding Grupim-Fondacion Ilija Kamçev dhe do të jetojë në vendbanimin e ri të ndërtuar, i cili është donacion i Qytetit të Shkupit.

Vendbanimi i gjirafës është shumë afër vendbanimit të elefantit i cili priret të arrijë në Kopshtin zoologjik në periudhën e ardhshme. Vendbanimet e reja janë ndërtuar në sipërfaqe prej rreth 4 000 metra katror, kurse vetë objektet shtrihen në një sipërfaqe prej 400 metra katror. Ato janë ndërtuar me material të fortë, me infrastrukturë të plotë, me ngrohje dysHEMEJE dhe çati. Vendbanimet kanë pjesë të brendshme dhe të jashtme.

Dy vendbanimet, e elefantit dhe gjirafës kushtuan rreth 20 milion denarë.



Në suazat e rikonstruksionit të Kopshtit zoologjik në katër vitet e fundit janë ndërtuar dhe lëshuar në përdorim 40-të vendbanime ndërmjet të cilave edhe për luanë, rakun, krokodilë, leopardë, rrëqebull, kangurë, emu, mjellmë e zezë, papagaj, shpendë grabitqarë – volier, antilopa aksis, drerë, gibbon, shpendë ekzotik, papagall ara, bufë dimri dhe pylli, terarium për zvarranikë me vendbanime për merkatë dhe vendbanim për majmunë.





Është përfunduar fa-za e parë e ndërtimit të Kopshtit botanik, është rregulluar hapësira, është ndërtuar sistem për ujitje dhe stacion pompe për sistemin e furnizimit me ujë, është vendosur edhe ndriçimi, janë ndërtuar vend panorama, 5 ura druri dhe rrethim mbrojtës, dhe janë rregulluar edhe 30 stola dhe 2 çezma.

U rinovuan vendbanimet e arinjve, buajve, gjedhëve ze-bu, lamave, drerëve, dhenve dhe dhive, strucëve, kuajve poni dhe drerëve fisnik.

Në Kopshtin zoologjik janë ndërtuar edhe Qendra edu-kative, tualet me platformë – vend panoramë, vend zbavitjeje për fëmijë, pesë vend panorama, rrethime mbrojtëse për vizitor-ët, tabela informative edukative për kafshët, liqen me shatërvan dhe urë, është rregulluar hyrja në Kopshtin zoologjik, dhe është vendosur edhe rrethim mbrojtës edukativ - pano me kafshë. Janë vendosur rreth tridhjetë stola dhe tridhjetë kosha për selek-sionimin e mbeturinave.

Në Kopshtin zoologjik jetojnë 500 kafshë, të 97 llojeve të ndryshme.



Kopshti zoologjik mori tren turistik, do-nacion nga Telekom i Maqedonisë SHA. Dhe T-Mobile Maqedonia. Treni është i gjatë dhjetë metra, ka 2 vagonë dhe është me kapacitet prej 36 ndenjësesh. Ka dizajn modern dhe është i vetmi i këtij tipi në regjion. Treni i ri është des-tinuar për shëtitje edukative nëpër Kopshtin zoologjik.

Në kopshtin zoologjik është vendosur ndriçim i ri dhe sistem për video-mbikëqyrje, do-nacion nga ELEM, EVN dhe nga MEPSO. Pajisjet e reja qytetarëve do t'u mundësojnë të kënaqen edhe me vizitën natën në Kopshtin zoologjik të Shkupit.





Në pjesën e parë të Parkut të qytetit ekipet e Qytetit të Shkupit në vitin 2011 ndërtuan katër çezma të reja të stilizuara për ujë. Çezma e parë është në formë shtatëkëndëshi me shtatë çezma prej gize, e dyta është vendosur tek Guaska dhe rrjedh si ujëvarë, në njërin nga çezmat është vendosur stema e Qytetit të Shkupit, kurse çezma e ndërtuar në terrenet për tenis është përgatitur prej hekuri të farkëtuar.

Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi rreth 1,2 milion denarë.



# PËRMBAJTJE TË REJA NË PARKUN E QYTETIT



Ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“ vendosën pllaka begatoni para Guaskës, në Parkun e qytetit. Me këtë aksion të Qytetit të Shkupit u rregulluan 200 metra katror.





Liçeni në Parkun e qytetit mori një pamje të re. Është betonuar fundi dhe pjerrësitë me sipërfaqe rreth 3 000 metra katror, gjë me të cilën u pengua rrjedhja e ujit dhe u përmirësua kualiteti i tij.

Për realizimin e këtij projekti Qyteti nga buxheti ndau rreth 3,8 milion denarë.

Si pjesë e aktiviteteve të rregullta për rregullimin e pajisjeve të parkut ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim“ lyen stolat në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit dhe riparuan stolat e dëmtuar.

U lyen edhe tualetet në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit.

Në pjesën e parë të Parkut të qytetit është rinovuar plotësisht sistemi për ujitjen e gjelbërimit dhe janë gërmuar 2 puse për ujë teknik.

Në pjesën e dytë të Parkut janë gërmuar 5 puse për ujë teknik. Për këtë projekt Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 5 milion denarë.

Ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim“ rregullisht krasitin degët e larta dhe presin degët e vjetra dhe të thara në Parkun e qytetit.



Qyteti i Shkupit pranverën e ardhshme në pjesën e parë të parkut do të vendosë gjashtë buste të personaliteteve të shquara të historisë së Maqedonisë. Qyteti i Shkupit shpalli konkurs për zgjedhjen e zgjidhjes

ideore për përgatitjen e busteve të personaliteteve të shquara të historisë së Maqedonisë, dhe atë të Orce Nikollov, Cvetan Dimov, Koço Racin, Kole Nedelkovski, Krste Misirkov dhe Nikolla Vapcarov. Bustet do të

përgatiten me dimensione të njëjta dhe do të vendosen në pjesën e parë të Parkut të qytetit në bazamentet e vjetra në të cilat qëndronin para se të shkatërroheshin dhe të hiqeshin.





Për më të rinjtë, në pjesën e parë të Parkut të qytetit, ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan dy kate për fëmijë me sipërfaqe 200 metra katror. Katet janë me ngjyra intensive dhe me përmbajtje të pasura dhe interesante, të destinuara për fëmijë të moshës deri në moshën 12 vjeçare.

Qyteti për ndërtimin e terreneve për fëmijë shpenzoi 350 000 denarë.



Qyteti i Shkupit në pjesën e parë të Parkut të qytetit vendosi gjashtë instalime hapësinore edukative në dy grupe tematike, „Njeriu dhe hapësira e tij” nga Risto Avramovski dhe „Në botën e fantazisë së fëmijëve” nga Ivana Topalovska. Çdo instalim edukativ është rregulluar në dy katet e reja është përgatitur sipas tematikës së përrallave të fëmijëve.

Në grupin e parë „Në botën e fantazisë së fëmijëve” janë vendosur tre instalime „Alisa në botën e çudirave”, „Magjistari nga Oz” dhe „Pinokio”, kurse në grupin tjetër të titulluar si „Njeriu dhe hapësira e tij” instalimet hapësinore janë „Nesi”, „Totem” dhe „Ksilofon”.



Qyteti i Shkupit për nevojat e qytetarëve të cilët ruajnë kanakarë në pjesën e dytë të Parkut të qytetit ndërtoi Park për kanakarët, me sipërfaqe rreth 1 200 metra katror, i cili është pajisur me përmbajtje të ndryshme dhe rekuizite për zbavitjen e kanakarëve. Në brendësi të parkut ka çezmë nga e cila mund të pinë ujë kanakarët, janë vendosur stola dhe tre shporta me rule me qese të vogla dhe të mëdha për grumbullimin e jashtëqitjeve të qenve.

Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi rreth 460 000 denarë.

Qyteti i Shkupit për t'i mbrojtur sipërfaqet e gjelbra në Parkun e Qytetit, vendosi tabela me të cilat informohen qytetarët ku mund të lëvizin dhe si duhet të sillen me kanakarët e tyre kur shëtisin nëpër park. Dhe në të njëjtën kohë t'i respektojnë obligimet ligjore.



Është blerë pajisje e re për kapjen e qenve endacakë gjë me të cilën u lehtësua puna e Shërbimit për trajtimin human të kafshëve të pastreha, pranë NP "Higjiena komunale".



Për të gjithë qytetarët e interesuar dhe vizitorët e Shkupit qarkullon Treni turistik në Shkup. Treni nis nga sheshi „Maqedonia“ dhe qarkullon nëpër korsinë e këmbësorëve në bregun e lumit Vardar, nën urën „Goce Delçev“, nëpër korsinë pas stadiumit „Filipi i Dytë“ deri në Luna park dhe prapa.

Treni qarkullon vetëm për fundjavë, kur ka kushte klimaterike të përshtatshme.

Qytetarëve të vet Qyteti i Shkupit u mundësoi të shfrytëzojnë internet ajror falas në Parkun e qytetit dhe në parkun „Zhenaborec“.





# 46 000 DRURË PËR RINOVIMIN E GJELBËRIMIT



Në zhardinierën e bulevardit të zgjeruar "Kliment Ohridski" janë mbjellë fidanë të llojit jargavan indian (lagerstroemia indica). Bëhet fjalë për 40 drurë dekorativ që lulëzojnë 100 ditë, nga qershori deri në shtator. Fidanët janë donacion i komunës Qendër.

Në katër vitet e fundit ekipet e Qytetit të Shkupit në sipërfaqet e gjelbra publike mbollën 46 253 fidanë gjetherënës, halor dhe kaçube të cilët kontribuan për gjelbërimin e Shkupit dhe për përmirësimin e kushteve në ambientin jetësor. Janë ndërtuar edhe është rregulluar hortikultura në sipërfaqe të gjelbra prej 223 213 metra katror, dhe është vendosur edhe rrjeti hidrant.

Në aksionet pranverore dhe të vjeshtës për ndarjen e fidanëve të gjithë qytetarëve të interesuar (këshillat banesor), bashkësi-ve urbane dhe vendore, institucioneve shëndetësore, kulturo-re, arsimore dhe publike në dy vitet e kaluara Qyteti i Shkupit u ndau 10 000 fidanë.





## „DITA E DRURIT“

Qyteti i Shkupit merr pjesë aktive në aksionin „Dita e drurit“ dhe organizon aktivitete për pyllëzim në park-pyillin „Vodno“ dhe „Gazi Baba“, si dhe në shumë lokalitete rreth Shkupit.



Ekipet NP „Parqe dhe gjelbërim“ vitin e kaluar rregulluan hortikulturën në tre zhardinierët në bulevardin „Vidoe Smilevski - Bato“. Gjelbërim i ri u mboll edhe në zhardinierën e mesme në bulevardin „Partizanski odredi“, në drejtimin nga ura „Obediniti naci“ deri në kryqëzimin tek Porta Vllae. Në vitin 2010 me gjelbërim u rregullua zhardiniera në bulevardin „Jane Sandanski“, në drejtimin nga qendra tregtare „Biser“ deri në kryqëzimin me bulevardin „Serbia“.

Mbajtësit e rendit komunal të Qytetit të Shkupit dhe komunave të Shkupit morën uniforma të reja. Qëllimi i vendosjes së uniformave të reja është që ruajtësit e rendit komunal të njihen nga qytetarët, t'i ruajnë sipërfaqet e gjelbra nga ndotja dhe të realizojnë në mënyrë të pandërprerë kompetencat që dalin nga Ligji për pastërtinë publike.

Uniforma e ruajtësve të rendit komunal është me ngjyrë blu dhe përbëhet nga këmbisha, pantallona, kapele, çorape, këpucë, rrip, triko dhe xhakete. Në mëngën e majtë të këmbishës qëndron mbishkrimi „Mbajtës i rendit komunal“ i shkruar në maqedonisht dhe në shqip.





# TREGU I LULEVE NË LOKACION TË RI



Tregu i luleve u transferua në lokacion të ri përballë Shtëpisë së shtypit, dhe mori një pamje plotësisht të re. Në sipërfaqe prej 242 metra katror janë ndërtuar 16 dyqane lulesh në dy rreshta.

Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan platformën në të cilën

janë vendosur dyqanet. Ndërtimi i shtëpizave është financuar nga qiramarësit, kurse paratë e investuara do t'u zbriten nga qiraja që duhet të paguajnë për hapësirën që shfrytëzo





# NJË MILION LULE PËR SHKUPIN MË TË BUKUR



Një milion lule u mbollën këtë vit në sipërfaqet e gjelbra në shumë lokacione nëpër qytet. Projekti „Shkupi i lulëzuar“ që realizohet nga Qyteti i Shkupit ka për qëllim zbukurimin e qytetit dhe të vërtetojë kujdesin për hapësirën dhe ambientin jetësor.

Ngastra të reja me lule janë formuar në Parkun e qytetit, tek Kopshti zoologjik, në gjelbërimin e bulevardit “Ilinden”, “Sveti Kliment Ohridski” dhe “Aleksandar Makedonski”, tek Kalaja e Shkupit, në parkun në lagjen Gjorçe Petrov, tek kryqëzimi tek hoteli „Kontinental“, në zhardinierët në bregun e lumit Vardar dhe në lokacione të tjera.





# KUJDESI PËR AMBIENTIN JETËSOR

Janë realizuar hulumtime hidrologjike-trase të ujërave nëntokësor në Fushëgropën e Pologut dhe Shkupit që ushqejnë burimin e Rashçes dhe ujërat e territorit të puseve Nerezi-Lepenec. Këto hulumtime japin të dhëna për sasinë, vjetërsinë dhe kualitetin e ujërave që ushqejnë burimin e Rashçes dhe territorin e puseve Nerezi – Lepenec, që mundësojnë realizimin e projeksioneve afatgjata për sasinë e ujit në burimet tona për furnizimin me ujë të pijshëm.

Janë realizuar hulumtime në truallin e Fushëgropës së Shkupit nga aspekti i ndotjes me metale të rënda. Ky projekt disa vjeçar në vitin 2013 do të përfundojë me përgatitjen e Atlasit gjeokimik që do të përmbajë të dhëna për gjendjen e truallit në lidhje me ndotjen me metale të rënda, si dhe rekomandime për veprimin me pikat „e nxehta“ (lokacionet me përqendrim të rritura të materieve ndotëse).

Qyteti i Shkupit realizoi monitorimin njëvjeçar hulumtues të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor në Fushëgropën e Shkupit, ujërat që ushqejnë burimin e Rashçes dhe ujërat që ushqejnë territorin e puseve Nerezi – Lepenec. Në të gjitha lokacionet relevante janë vendosur vende matëse dhe janë ndërtuar pizometra për ndjekjen e ujërave nëntokësor. Monitorimin e ujërave e vazhdon NP „Ujësjellës dhe kanalizim“.

Për këtë projekt voluminoz Qyteti i Shkupit ndau rreth 12,2 milion denarë.

Kualiteti i ajrit në qendrën e Shkupit nga vitit 2011 matet nga ekran special i cili në mënyrë figurative tregon vlerat momentale të matura të materieve ndotëse në ajër dhe jep rekomandime për shëndetin e qytetarëve.

Ekranin mat sasinë e monoksidit të karbonit, dyoksidit të sulfurit, oksidit të azotit dhe grimcave partikulare më të vogla se 10 mikrometra, dhe maten edhe parametrat meteorologjikë – temperatura e ajrit, shpejtësia dhe drejtimi i erës dhe lagështia e ajrit.



Aksioni për pastrimin e sipërfaqeve publike në dhjetë komunat e Shkupit nën moton „Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbër“ realizohet dy herë në vit. Në pastrimin e depove informale, kositja e barit, rregullimi i gjelbërimit, kontrolli i rrjetit të kanalizimit, pastrimi i vend derdhjeve dhe riparimi i gropave të mëdha të rrugëve përfshihen ndërmarrjet publike „Parqe dhe gjelbërim“, „Higjiena komunale“, „Ujësjellës dhe kanalizim“ dhe „Rrugë dhe rrugica“.



Qyteti i Shkupit në vitin 2011 hyri në familjen e madhe prej 2 688 qyteteve evropiane të cilët çdo vit organizojnë fushatën më të përhapur për mobilitet të qëndrueshëm – Java evropiane e mobilitetit. Në Shkup u mbajtën shumë aktivitete për promovimin e monolitit alternativ dhe për ngritjen e vetëdijes ekologjike, kurse për organizimin efektiv dhe inovues të manifestimit Qyteti i Shkupit hyri në 10-të qytete e para sipas klasifikimit.



Qyteti i Shkupit përgatiti projekte për efikasitet energjetik për objektet e 21 shkollave që janë nën kompetencat e tij. Qëllimi i këtij aktiviteti është që nga viti i ardhshëm të ndërmerren aktivitete ndërtimore për të kursyer energjinë në shkolla.

Aktivitetet për mbrojtjen e ambientit jetësor, të parashikuara me Planin ekologjik lokal të dytë për Shkupin (PAEL 2), zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar.

PAEL 2 është dokument strategjik i cili përcakton ndryshimet në ambientin jetësor në qytet në 5 vite e fundit dhe parashikon masa dhe aktivitete për mbrojtjen dhe avancimin e ambientin jetësor. Dokumenti përfshin pesë fusha tematike: mbeturina, ujë, ajër, truall dhe natyrë, konstaton ndryshimet në ambient dhe nxit bashkësinë lokale të ndërmarrë masa konkrete për ruajtjen dhe përmirësimin e ambientit jetësor.

Sipërfaqet e pjerrëta në bregun e lumit Vardar rregullisht pastrohen nga vegetacioni i rritur i egër dhe nga mbeturinat. Pastrohen edhe shtrati i lumit Lepenec, kanali Usjanski dhe kanalet në Przhino dhe Kozle.

Kanali i hapur Vodnjanska në vitin 2010 u mbulua, kurse për përmirësimin e funksionalitetit u mbulua kanali i furnizimit me ujë për liqenet në Parkun e qytetit.



Në ambientet e Qytetit të Shkupit u hap Zyra për menaxhimin me energjinë dhe Qendra informative për efikasitet energjetik dhe burime ripërtëritëse të energjisë. Në zyrë qytetarët mund të marrin informacione të zbatueshme se si të zvogëlojnë shpenzimin e energjisë në shtëpitë e tyre.



Kopshtet „Tashko Karaxha“ në komunën Butel, „Koço Racin“ në komunën Qendër, „Orce Nikollov“ në komunën Karposh, „8 Marsi“ në komunën Kisela Voda, „Drenushja“ në komunën Aerodrom, „Gëzimi fëmijëve“ në komunën Gazi Baba, „Fidani“ në komunën e Çairit, „Snezhana“ në komunën Shuto Orizare, „Rosica“ në komunën Gjorçe Petrov dhe shkolla „Liria“ në komunën e Sarajit morën nga një komplet koshash për seleksionimin e mbeturinave. Koshat e rinj që i bleu Qyteti i Shkupit, janë në formën e kafshëve – ari, delfin dhe bretkosë dhe në ta mund të grumbullohen letra, plastikë dhe kanoçe. Gjashtë komplete me nga tre kosha janë vendosur edhe në Kopshtin zoologjik.

Për blerjen e koshave Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 1,8 milion denarë.

# NË BREGUN E LUMIT VARDAR



Plazhi "Park"

Plazhi i qytetit „Park“, në bregun e lumit Vardar, në vitin 2010 u mundësoi qytetarëve të Shkupit të freskohen dhe relaksohen në ditët e nxehta të verës. Projekti „Nga asfalti i nxehtë – drejt në plazh, një hap afër teje“ vizitorëve u ofroi rërë plazhi, shezlonge, banakë për pije, dushe, rekuizite për fëmijë dhe muzikë argëtuese. Plazhi shtrihet në një sipërfaqe prej 1 775 metra katror.

Në maj të vitit të kaluar Shkupi u bë edhe me plazhin e dytë të qytetit. Plazhi „Ura e gurit“ gjendet në anën e majtë të bregut të lumit Vardar, ndërmjet urave „Goce Delçev“ dhe Urës së gurit. Në plazh janë vendosur streha dhe platforma druri, 20 tavolina, 80 stola dhe 80 shezlonge. Ka edhe katër banakë, kat për fëmijë me lëkundës, skenë për mbajtjen e manifestimeve, dushe, dhoma për zhveshje, çezma për ujë, vende parkimi për biçikleta dhe kosha për mbeturina.

Në ndërtimin e plazhit të Qyteti i Shkupit investoi rreth 9 milion denarë.



Plazhi "Ura e gurit"



Në të dy plazhet e Qytetit ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan terrene për volejboll ku të gjithë të interesuarit mund t'i shfrytëzojnë falas.

Në terrenin sportiv të plazhit „Park“ këtë vit për herë të tretë u mbajt Turne ndërkombëtar në volejboll në rërë „Shkupi 2012“, në konkurrencën për femra dhe meshkuj. Sponsor i turneut është kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, kurse organizator teknik është Federata e voleybollit e Maqedonisë.



Të gjithë qytetarët e interesuar, nxënës, studentë, klube sportive dhe shoqatat e qytetarëve 1 gusht mund të shfrytëzojnë falas terrenin sportiv multi-funksional për hendboll dhe futboll në rërë, në Plazhin e Qytetit „Park“. Orari për shfrytëzimin e terreneve mund të caktohet nëpërmjet telefonave 3297-238 dhe 3297-320, çdo ditë pune, ose në vetë terrenin sportiv.



Nëpër bregun e lumit Vardar, nga ana e majtë, ekipet e Qytetit të Shkupit këtë vit ndërtuan edhe një pjesë të korsisë për patina – biçikleta, në drejtimin nga bulevardi “Goce Delçev” në bulevardin “8. Septemvri”. Korsia e re është e gjatë 3 000 metra, dhe është asfaltuar dhe shënuar.

Për realizimin e projektit Qyteti i Shkupit ndau rreth 16,5 milion denarë. Përgjatë korsisë është vendosur edhe ndriçimi i ri rrugor.

Korsia për patina – biçikleta e cila në vitin 2010 u ndërtua nga qendra deri te fabrika „Komuna“ gjatë vitit 2011 u zgjatua deri te ura Todor Aleksandrov (ura e mëparshme “Bliznak”). Kjo pjesë e korsisë është e gjatë 2 338 metra, e gjerë 4 metra dhe u shtrua me asfalt.

Qyteti i Shkupit për këtë vepër ndërtimore shpenzoi rreth 7 milion denarë.

Qyteti i Shkupit në disa lokacione përgjatë bregut të lumit Vardar vendosi rekuizite sportive për ushtrim dhe rekreacion. Punte të tilla ka në Plazhin e qytetit, tek ura Todor Aleksandrov (ura e mëparshme “Bliznak”), në lagjen Aerodrom dhe tek hoteli „Aleksandar Pallas“.





# AKTIVITETE SPORTIVE

Në rrugët e qytetit, në muajin maj, tradicionalisht mbahet maratona ndërkombëtare e Shkupit. Sponsorë të këtij manifestimi tradicional sportiv janë Qyteti i Shkupit, Agjencia për të rinj dhe sport dhe Misioni i BE-së në Shkup, organizatorë teknikë janë Lidhja e sporteve e Shkupit dhe KA „Rabotnički“, kurse organizatorë të përbashkët janë Federata e atletikës e Maqedonisë. Përveç ndihmës financiare, Qyteti i Shkupit ofron edhe ndihmë logjistike nëpërmjet ndërmarrjeve publike të veta, kurse përkrahës të Maratonës së Shkupit janë edhe Ministria për punë të brendshme, Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, Fakulteti për kulturë fizike dhe ARM.



Me rastin e 13 Nëntorit – Dita e çlirimit të Shkupit mbahen dy gara tradicionale nate, Gara e Natës në atletikë dhe Gara e Natës në çiklizëm „Nëpër rrugët e Shkupit“.

Organizator i Garës së Natës në atletikë është Federata e at-



letikës së Maqedonisë, kurse i Garës së Natës në çiklizëm Federata e çiklizmit të Maqedonisë. Sponsor i garave është Qyteti i Shkupit.



Turneu ndërkombëtar i boksit „Gongu i artë“ këtë vit u organizua për të 42-ën herë. Në këtë turne matën forcat boksierë nga shumë vende nga Evropa dhe nga bota, ndërmjet të cilëve nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Bjellorusia, Italia, Rumania, Çekia, Serbia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Rusia, Moldavia, Tunizia, Spanja, Kuba dhe nga Maqedonia.



Në korsinë e lumit Treska në QRS „Matka“ këtë vit u mbajt edicioni i 44-ët i Slallomit ndërkombëtar linden në kanu - IKAS 2012, në konkurrencën për meshkuj dhe femra.



Në qendrën sportive „Boris Trajkovski“ vitin e kaluar u mbajt jubileu i 10-të i Kupës së klubeve evropiane në boiling NBC me pjesëmarrjen e rreth 500 garuesve nga 31 klube, nga pothuajse të gjitha vendet evropiane. Sponsor i këtij manifestimi sportiv ishte Qyteti i Shkupit, kurse organizator Federata e boiling e Maqedonisë.



Është ndërtuar terren sportiv në fshatin Jurumleri në komunën Gazi Baba. Terreni sportiv është me sipërfaqe prej 1 000 metra katror dhe është pajisur me rekuizite për futboll dhe basketboll.

Për ndërtimin e terrenit sportiv dhe për rregullimin e hortikulturës së parkut afër tij janë shpenzuar rreth 8 milion denarë, kurse NP „Rrugë dhe rrugica“ mori pjesë me rreth 1,2 milion denarë.

Në vitin 2009 u rinovua qendra sportive-rekreative në qendrën e komunës Shuto Orizare. Qyteti i Shkupit këtë projekt e ndihmoi me tabela për kosha, stola, kosha për mbeturina dhe kandelabër.



# MBROJTJA SOCIALE, E FËMIJËVE DHE SHËNDETËSORE



Qyteti i Shkupit lëshoi në përdorim 3 automjete speciale të adaptuara për nevojat e personave me invaliditet më të rëndë. Tre automjetet janë pajisur me platformë speciale automatike për ngritjen e karrocës së invalidëve dhe pajisje të tjera që garantojnë siguri për përdoruesit.

Investim i Qytetit të Shkupit është rreth gjashtë milion denarë.

Për nevojat e Seksionit për nefrologji pranë Spitalit të përgjithshëm të qytetit „8. Shtatori“ dhe të Institucionit publik shëndetësor „Hekuruna“ Qyteti i Shkupit dhe komuna Qendër në fillim të vitit 2012 dhuruan 2 aparate për hemodializë për pacientët e



sëmurë nga veshkat. Me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe komunës Qendër për blerjen e aparateve u siguruan 1 000 000, përkatësisht 200 000 denarë.



Në vitin 2010 u lëshua në përdorim pjesa e re e punktut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit për të pastrehët, në Momin Potok. Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit ndau 1,4 milion denarë.

Me hapjen e strehimore, kapacitetet e punktut u rritën për 60 metra katror. Ambienti i ri është pajisur me krevate, tualet, kuzhinë për çaj dhe mjete të tjera të domosdoshme gjë me të cilën mundet plotësisht t'u përgjigjet nevojave të këtyre personave.



Platformë ashensori e cila është destinuar për persona të cilët lëvizin me ndihmën e karrocës në vitin 2010 u vendos në SHMQSH „Mihajlo Pupin“. Platforma është e para dhe e vetme e këtij tipi në Maqedoni dhe siguron qasje deri në të gjitha katet e shkollës.

Drejtimi me platformën është me butona që janë adaptuar edhe për përdorimin nga persona të verbër, kurse për këtë qëllim nga Buxheti i Qytetit të Shkupit janë ndarë rreth 2,5 milion denarë.





Çdo verë, Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit realizon aktivitete për përkrahje në intervenime në gjendje krize për veprim të shpejtë dhe efikas në rast fatkeqësish, kur temperatura ngjitet mbi 40 gradë celsius. Ekipet mobile të Kryqit të kuq vizitojnë vendet me frekuencë më të madhe në qytet dhe shpërndajnë shishe me ujë, masin tensionin e gjakut, kurse atje ku ka nevojë japin ndihmën e parë dhe transportojnë personat e moshuar dhe të rraskapitur deri në shtëpitë e tyre.

Çdo vit për përkrahjen e aktiviteteve të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, për intervenime në gjendje krize, Qyteti i Shkupit ndan 500 000 denarë nga Buxheti.



Qyteti i Shkupit këtë vit merr pjesë me 500 000 denarë në rinovimin e Qendrës rekreative „Katlanovo“ për të adaptuar për përdorim ambientet për rekreacion të pensionistëve. Në vitin 2011 për rinovimin e pushimores në QR „Katlanovo“ Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 350 000 denarë.



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 10 qershor të këtij viti edhe zyrtarisht hapi Qendrën ditore për persona të moshuar për dhënien e ndihmës në kushte shtëpiake, të cilët janë akomoduar në ambientet e shtëpisë „Dare Xhambazov“, në rrugën „11 Oktomvri“ dhe në rrugën „Vukovarska“ numër 23, në komunën e Çairit.

Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti për dhënien ndihmë personave të moshuar nga Buxheti ndau 2 milion denarë.






Në suazat e ambulancës „Vodno“, në rrugën Elisije Popoviq numër 2 është hapur Këshillimorja e parë për preventivë nga përdorimi i drogave tek nxënësit e shkollave të mesme në Shkup, Qendra rinore „Dua të di“.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që të rinjtë në Shkup të kenë qasje më të mirë dhe më të lehtë deri te informacionet dhe këshillat



për preventivën nga drogat dhe ballafaqimin me problemet nga përdorimi i drogave. Projekti „Këshillimore dhe edukim për preventivën nga përdorimi i drogave tek nxënësit e shkollave të mesme në qytetin e Shkupit“ e realizoi H.E.R.A - Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtime, me përkrahje financiare nga Qyteti i Shkupit në vlerë prej 1 000 000 denarë.



„Shkupi – qytet i barazisë gjinore“ është titulli i Strategjisë për barazi gjinore të Qytetit të Shkupit që u promovua më 8 mars të këtij viti. Strategjia përbën dokument gjithëpërfshirës i cili shpreh politikat e Qytetit dhe planet për realizimin e vizionit të Shkupit që të transformohet në qytet me barazi gjinore.

Qyteti i Shkupit çdo vit financon dhe ndihmon edhe Shtëpinë për persona të moshuar në Zllokuqani „Nënë Tereza“.



# 85 MILION DENARË PËR RIKONSTRUKSION E SHKOLLAVE TË MESME



Qyteti i Shkupit katër vitet e kaluara shpenzoi rreth 85 milion denarë për rikonstruksionin e godinave të të gjitha shkollave të mesme, 21 që janë nën kompetencat e tij, me qëllim përmirësimin e kushteve për punë të nxënësve dhe të të punësuarve.

Në një pjesë të shkollave u rinovuan nyjat sanitare, sipërfaqet e murit dhe dyshemetë, në një pjesë është zëvendësuar zdrukthëtaria dhe çatitë e vjetra prej azbesti, në disa godina shkollore është përfunduar rikonstruksioni i sallave sportive.

Në shkollën e mesme „Marija Kyri–Skłodovska“ u pajisën klasa të specializuara për degën e shëndetësisë në profilin arsimor për teknik laborator dhe teknik laborator mjekësor.







Nxënësit e vitit të parë në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit kanë mundësi të ndjekin mësimin e notit, që realizohet në arenën e notit „Boris Trajkovski“. Në projektin për mësimin e notit janë përfshirë instruktorë noti profesionistë, tre shpëtues me licencë nga Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, si dhe dhjetë studentë nga Fakulteti i kulturës fizike, të cilët punojnë si vullnetarë me nxënësit.

Projektin për realizimin e mësimin të notit nga viti i parë në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit e financojnë Qeveria e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet Ministrisë së arsimit dhe shkencës dhe Byrosë për zhvillimin e arsimit, kurse përkrahjen logjistike për organizimin e orëve e jep Qyteti i Shkupit.

Më 5 maj në ambientet e SHMQSH „Georgi Dimitrov“ u mbajt gara në matematikë ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit. Gjimnazistët nga viti i parë, i dytë dhe tretë matën dijet në lëndën e matematikës të ndara në dy grupe, sipas programeve mësimore, përkatësisht nxënës të gjimnazeve dhe nxënës të shkollave të arsimit profesional. Fituesit morën diploma dhe shpërblime në para.



Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski në suazat e manifestimit tradicional „Takim ndërmjet më të mirit dhe më të mirëve“, të maturanëve më të mirë – nxënës të shkëlqyer të gjeneratës 2008/2012 nga 21 shkolla të mesme u ndau mirënjohje dhe shpërblime në të holla.



Çdo shkollë e mesme e Qytetit të Shkupit në vitin 2011 mori nga 33 topa lëkure të brenduara për vënien në praktikë dhe masivitetin e sporteve më popullore: basketboll, volejboll, futboll dhe hendboll.

U mbajtën Garat e Ligës në konkurencën për meshkuj dhe femra ndërmjet ekipeve të shkollave të mesme në Shkup, në disa sporte, dhe atë në futsall, hendboll, volejboll, basketboll, boiling, ping-pong, atletikë dhe volejboll në rërë.



Në oborrin e SHMQSH „Zdravko Cvetkovski“ është ndërtuar një mini terren me korsi për atletikë dhe vrapim sprint në 100 metra, korsi për kërcim së gjati dhe platformë dhe terren për hedhje gjyleje.

Terreni u ndërtua nga ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“, kurse për këtë projekt Qyteti i Shkupit ndau 1,1 milion denarë.

Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan mini terrene atletike për sprint në 60 metra, tre hapësh, kërcim së gjati dhe hedhje gjyleje në oborrin e shkollës „Arsenij Jovkov“.





Basketboll, voleyboll, hendboll, futsall dhe atletikë ishin sportet në të cilat matën forcat gjimnazistët nga 48 ekipe të shkollave të mesme nga e gjithë Maqedonia në „GJIMNAZIADA SHKUPI 2010“ të shtatë, e cila u mbajt nga data 6 deri më 8 maj 2010 në Shkup.

„Fol hapur për dhunën“ ishte motoja e manifestimit përfundimtar të projektit „Zvogëlimi i dhunës dhe rritja e sigurisë në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit“ i cili u mbajt më 6 qershor në oborrin e shkollës së mesme „Pançe Arsovski“. Projekti për zvogëlimin e dhunës, i cili u realizua gjatë shumë muajve në të gjitha shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, ka si qëllim të trajnojë shkollat si të zhvillojnë politikatat shkollore, protokollet dhe programet për preventivë, identifikim dhe ballafaqim me dhunën. Projekti është iniciuar nga Qyteti i Shkupit.

Në fund të vitit shkollor në sheshin „Pela“ dhe në rrugën „11 Oktomvri“ maturantët nga shkollat e mesme të Shkupit luajtën vallëzimin „kuadril“. Me këtë, maturantët e Shkupit u përfshinë në manifestimin ndërkombëtar „Parada e maturës“, në të cilën përfshihen maturantë nga shumë vende nga Evropa.



# BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

## SHKUPI U VËLLAZËRUA EDHE ME ZAGREBIN DHE BEOGRADIN...

Me nënshkrimin e Kartës për miqësi dhe bashkëpunim ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Zagrebit, nga kryebashkiakët Koce Trajanovski dhe nga Millan Bandiq, Shkupi dhe Zagrebi u bënë qytete të vëllazëruara.

Qyteti i Shkupit më 26 mars u vëllazërua me Qytetin e Beogradit. Marrëveshjen për vëllazërimin ndërmjet dy qyteteve në Beograd e nënshkruan kryebashkiakët Koce Trajanovski dhe Dragan Gjilas.

Me aktin e nënshkrimit ndërmjet qyteteve u hap mundësi më e madhe për këmbimin e eksperiencave dhe bashkëpunim në shumë fusha të jetës shoqërore, veçanërisht për zgjidhjen e problemeve të qarkullimit rrugor, çështjeve urbanistike dhe për zhvillimin e arsimit.



Zyra e re e hapur e Qytetit të Shkupit dhe BNJVL në Bruksel i solli Qytetin e Shkupit dhe Republikën e Maqedonisë një hap më afër Evropës, hap që do të mundësojë informimin në kohë për fondet evropiane për vetëqeverisje lokale, prezantimin dhe përfaqësimin e pushteteve lokale para institucioneve të BE-së, nxjerrjen e eksperiencave dhe lobim për shfrytëzimin e fondeve dhe ndihmave të tjera të nevojshme për vetëqeverisjet lokale.

Qyteti i Shkupit hapi Qendër-OJQ në ambientet e Qendrës kulturore rinore. Për qytetarët është në dispozicion edhe portali — OJQ [www.skopje.gov.mk/nvo](http://www.skopje.gov.mk/nvo)





Presidenti i Republikës së Malit të Zi, Filip Vujanoviq, në ceremoninë solemne, që u mbajt më 17 mars të këtij vitit, u shpall Qytetar nderi i Shkupit. Zotit Vujanoviq pllakatin „Qytetar nderi i Shkupit“ ia ndau kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Presidenti Vujanoviq është mik i madh dhe respektues i Republikës së Maqedonisë dhe qytetit të Shkupit, politikan bashkëkohor, burrë shteti i madh, humanist dhe promotor i bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Malit të Zi dhe Maqedonisë.



Organizata joqeveritare ndërkombëtare „Klubi ballkanik i paqes“ më 21 janar të këtij vitit Qytetit të Shkupit i ndau çmimin „Karta ballkanike e paqes“. Mirënjohja i jepet Qytetit të Shkupit për shërbimet e tij dhe aktivitetet për zgjerimin e ideve të paqes dhe miqësisë, si në Ballkan ashtu edhe më gjerë.



Më 23 maj në Torino kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe kryebashkiaku i Torinos, Piero Fasino, nënshkruan Kontratë për miqësi dhe bashkëpunim ndërmjet dy qyteteve. Në suazat e këtij bashkëpunimi Qyteti i Shkupit do të fillojë aktivitetet për formimin e zyrës për planifikimin hapësinor dhe urbanistik (Qendra urbane - Shkup).

Qyteti i Shkupit nga data 3 deri më 12 shtator 2009 ishte nikoqir i manifestimit cilësor kulturor „Bienale e të rinjve nga Evropa dhe Mesdheu“. Nëntë ditë në Shkup rreth 800 artistë, të moshës ndërmjet 18 dhe 30 vjeçare, krijuan në shtatë disiplina arti – arte vizuale, art i aplikuar, performansa, letërsi, muzikë, gastronomi dhe art filmik. Artistët erdhën nga 48 vende nga Ballkani, Lindja e mesme, Mesdheu dhe nga vendet-anëtare të Bashkimit evropian.

Sekretari i Qytetit të Shkupit, Gordana Klinçarova, në Sarajevë, së bashku me kryebashkiakët e Sarajevës, Podgoricës, Tiranës, Zagrebit dhe Frajburgut nënshkruan Memorandumin për mirëkuptim ndërmjet kryeqyteteve të Evropës Juglindore. Akti i nënshkrimit të Memorandumit për mirëkuptim është fillimi zyrtar i projektit „Fuqizimi i rrjetit të qyteteve efikase energjetike në Evropën juglindore“ që do ta realizojnë administratat e qyteteve nënshkrues dhe partneri dhe iniciatori i projektit SIGJ-Shoqata gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar.

## Këshilli i Qytetit të Shkupit

# PËRKRAHJE PA REZERVË PËR PROJEKTET KAPITALE TË QYTETIT

Si kryetare e Këshillit të Qytetit të Shkupit, dua të shpreh kënaqësinë time personale nga puna e deritanishme e Këshillit të Qytetit të Shkupit, për të cilën flasin edhe 72 seancat e rregullta të mbajtura, 8 të jashtëzakonshme dhe 1 seancë solemne, e cila për të gjithë ne ishte shumë e rëndësishme, sepse në këtë seancë u kremtua tridhjetëvjetori i shpalljes së Nënë Terezës qytetar nderi i Shkupit.

Në periudhën pas nesh kishim shumë obligime, u ballafaquam me shumë sfida të cilat vinin para nesh si këshilltarë, por pikërisht për këtë dhe me krenari të veçantë them se pas të gjithë projekteve të suksesshme të Qytetit të Shkupit gjithmonë ishim logjistikë dhe përkrahje e madhe në punën e kryetari të Qytetit të Shkupit, zotit Koce Trajanovski.

U votuan shumë vendime dhe programe të cilat kishin rëndësi thelbësore për qytetarët e Shkupit, dhe me këtë rast do të desha të përmend disa prej tyre: Themelimi i Shoqërisë për veprimtari sportive – Klubi i futbollit Vardar SHA; Themelimi SHPK „Drisla“; Bashkëpunim me regjionin planifikues të Shkupit për realizimin e projekteve, identifikimin e potencialeve investuese, iden-

tifikimin dhe promocionin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore etj.; Ndërtimi garazheve me kate (tek Stacioni i vjetër hekurudhor dhe tek Ringu i vogël); Rikonstruksioni i urave („Goce Delçev“, „Ura e revolucionit“); Ndërtimi i godinës për administratën e Qytetit të Shkupit; Furnizimi me automjete për nevojat e NP „Higjiena komunale“; Furnizimi me automjete për nevojat e NP „Rrugë dhe rrugica“; Blerja e pajisjeve për QMKK; Furnizimi me biçikleta; Furnizimi me tezga për nevojat e shitësve të librave të vjetër; Furnizimi me ashensorë dhe platforma për nevojat e personave me nevoja të veçanta në institucionet publike (SHMQSH „Arsenij Jovkov“, „Mihajlo Pupin“ dhe „QKR“); Furnizimi me pajisje për Brigadën MKZ të Qytetit të Shkupit; Programi për rigjallërimin, ri-kultivimin dhe rregullimin e hapësirës së depos së mëparshme të qytetit për grumbullimin e mbeturinave „Vardarishte“; Ndërtimi i vendeve për kontejnerë; Programi për rikonstruksionin e fasadave në territorin e qendrës së qytetit; Programi për trajtimin human dhe kontrollin e qenve endacakë; Ndërtimi i korsive për patina, biçikleta dhe këmbësorë; Programi për varrezat „Butel“; Programi për zhvillimin e arteve kreative; Ndërtimi dhe



*Irena Misheva,  
Kryetare e Këshillit të  
Qytetit të Shkupit*

rikonstruksioni i rrugëve dhe bulevardeve: „Boris Trajkovski“, „Mitropolit Teodosij Gologanov“, „Serbia“, „Ilinden“...; Ndërtimi i unazës në Gjorçe Petrov; Bashkëpunimi ndërmjet komunave që nënkupton se në çdo komunë të Qytetit të Shkupit u realizuan aktivitete të caktuara në varësi të prioritetëve në komuna; Transporti falas për pensionistët të martën, të premten dhe të shtunën; Sjelja e Draft-Planit të përgjithshëm urbanistik (PPU) për Qytetin e Shkupit dhe shumë vendime të tjera.

Falë mirëkuptimit të ndërsjellët, konsistencës dhe para së gjithash vendosjes së lartë morale dhe etikës të këshilltarëve nga njëra anë, si dhe të bashkëpunimit të mirë me kryetarin e Qytetit të Shkupit dhe administratën nga ana tjetër, arritëm t'i realizojmë plotësisht të gjitha sfidat të cilat na u vendosën nga fillimi i mandatit.





# Vizita pune në të gjitha komunat e Shkupit

## 4 VJET TAKIME TË DREJTPËDREJTA ME QYTETARËT



Kryetari i qytetit të Shkupit Koce Trajanovski katër vitet e kaluara dy herë në vit vizitoi dhjetë komunat e Shkupit dhe realizoi takime me kolegët e tij kryetarë të komunave. Në takime morën pjesë edhe drejtorët e ndërmarrjeve publike të qytetit, drejtuesit e sektorëve të administratës së qytetit, përfaqësues të administratave të komunave, si dhe përfaqësues të bashkësive urbane dhe vendore të komunave.

Në këto takime u bisedua për problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët e Shkupit në jetën e tyre të përditshme, u ofruan propozime dhe ide për tejkalimin e tyre, si dhe propozime për përmirësimin e punës së ndërmarrjeve publike. Në mënyrë plotëse, në takimet që u mbajtën në pjesën e dytë të vitit kalendarik, komunat dhe qytetarët nëpërmjet propozimeve të projekteve kanë mundësi të marrin pjesë në krijimin e buxhetit të Qytetit të Shkupit

për vitin e ardhshëm.

Takimet që u mbajtën vitin e kaluar rezultuan me realizimin e një numri të madh të projekteve të cilat i propozuan komunat dhe qytetarët, para së gjithash në fushën e qarkullimit publik, higjienës komunale dhe transportit publik.

Përfaqësuesit e bashkësive urbane dhe vendore, si dhe kryetarët e komunave të Shkupit këto takime i vlerësuan si pozitive, pikërisht si mënyrë e punës transparente të vetëqeverisjes lokale për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Shkupit.



## DITË E HAPUR PËR TAKIME ME QYTETARËT

Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, çdo të premte të fundit të muajit mban takime me qytetarët dhe bisedon me ta për problemet me të cilat ballafaqohen çdo ditë, dhe që janë nën kompetencat e Qytetit të Shkupit. Dita e hapur me qytetarët kontribuoi për transparencë më të madhe në punën e Qytetit të Shkupit, shkëmbimin e ideve dhe për zgjidhjen e problemeve shumëvjeçare të qytetarëve të Shkupit.



# KINEMAJA E QYTETIT „MILENIUM“ TASHMË TREDIMENSIONALE



Në dhjetor të vitit 2010 përsëri u hap vendi kult për adhuruesit e filmit dhe punëtorët e filmit – Kinemaja e qytetit „Milenium“, gjë me të cilën u përsëri u gjallërua një traditë e qytetit. Qyteti i Shkupit lidhi kontratë me Qendrën tregtare të qytetit për marrjen e kinemasë „Milenium“, kurse disa vite me radhë me të menaxhon me sukses IP „Qendra kulturore rinore“. Shkupi kishte nevojë për një sallë kinemaje reprezentative, pikërisht për këtë, me hapjen e sërishme të kinemasë „Milenium“, Qyteti i Shkupit arriti t'i plotësojë nevojat e të gjithë adhuruesve të artit të shtatë, por edhe të ndjekë ha-

pin me teknologjitë e reja moderne të filmit, duke instaluar pajisjen më moderne 3D, gjë me të cilën kjo kinema u bë vend ku mund të shikohen blok-baster më të reja të produksionit botëror dhe vendas.

Teknologjia e re 3D në „Milenium“ është pajisja 3D më aktuale dhe më e re në tregun botëror. Për realizimin e projektit për pajisjen e kinemasë së qytetit „Milenium“ me teknologjinë më të re 3D nga Buxheti i Qytetit të Shkupit u ndanë rreth 8 500 000 denarë.

## SHIKO MUZIKË, DËGJO PIKTURË, MERR LIBËR

Në pjesën e parë të Parkut të qytetit tanimë pesë vjet me radhë mbahet manifestimi multimedial „SHIKO MUZIKË, DËGJO PIKTURË, MERR LIBËR“. Nikoqir i publikut të shumtë në park tradicionalisht janë Filarmonia maqedonase dhe Qendra kulturore rinore. Repertori i temave të luajtura çdo vit është i ndryshëm, por plotëson shijet e ndryshme muzikore. Piktorët pikturojnë në kanavace të mëdha dhe me krijimet e tyre origjinale ngjyrosin notat e luajtura nga instrumentistët e filarmonisë në skenë.

Publiku në këtë eveniment të pazakontë mund të largohet edhe me libër në dorë, çdo vit me vepër të ndryshme të botuar në 20 000 kopje për këtë qëllim.





## FESTIVALI NDËRKOMBËTAR „TEATRI I RI I HAPUR“

Festivali ndërkombëtar Teatri i ri i hapur (MOT), për herë të parë u organizua nga Qendra kulturore rinore në maj të vitit 1976, kurse këtë vit u realizua edicioni i 37-të. MOT prezantoi dhe mundësoi këmbimin/qarkullimin e energjisë së re, të freskët, eksperimentale, avangarde si dhe eksperiencë ndërmjet pjesëmarrësve të shfaqjeve teatrale. Çdo vit festivali mbahet nën moton e re dhe në përputhje me të zgjidhen pjesëmarrësit e festivalit. Këtë vit motoja e MOT është „Diçka është e kalbur“, kurse në gjashtë ditët teatrale të festivalit do të ketë shumë ligjërime, punëtori, trajnime, prezantime dhe promociione.

Nëpër vitet e mbajtjes dhe rritjes, MOT krijoi identitetin e vet: vërtetoi karakterin ndërkombëtar me shfaqjet e 380 teatrove të ndryshme dhe grupeve alternative nga e gjithë Evropa, SHBA, Kanadaja, Venezuela, India, Japonia, Republika e Koresë, Mali etj. Qyteti i Shkupit, tradicionalisht, e përkrah këtë festival, kurse këtë vit për mbajtjen e tij nga Buxheti ndau 1 500 000 denarë.



## NJË DEKADË FESTIVAL I FILMIT EVROPIAN „CINEDAYS“

Vitin e kaluar u kremtua ditëlindja e 10-të e Festivalit të filmit evropian „CINEDAYS“, që zgjati dhjetë ditë, kurse publikut të Shkupit iu mundësua që në 5 salla të kinemasë të ndjekë rreth 70 realizime filmike nga produksioni më i ri filmik. Festivali jubilar i



Filmit evropian, organizator i të cilit është Qendra kulturore rinore, arriti për një kohë të shkurtër të shndërrohet në festival prestigjioz filmik me fizionominë karakteristike dhe konceptin e vet. Rritja e festivalit ka të bëjë me përkrahjen në vazhdimësi nga Komisioni evropian, si dhe nga vendet e Bashkimit Evropian, kontributi dhe bashkëpunimi i të cilëve bëjnë që festivali të jetë një festë e vërtetë e artit filmik në Shkup. Në suazat e festivalit, çdo vit, mbahen projeksione të shumta filmike dhe premiera, koncerte muzikore, ligjërata, punëtori të cilat një rrethi të gjerë adhuruesish filmik u afrojnë dhe prezantojnë magjinë e filmit dhe krijimtari.

Këtë vit „CINEDAYS 2012“ u mbajt nga data 15 deri në datën 25 nëntor.

## TËRË NATËN, NATË E BARDHË



Të gjitha institucionet kulturore të Qytetit të Shkupit përfshihen në realizimin e programit për natën më të gjatë kulturore në Shkup „NATA E BARDHË“. Adhuruesit e artit mund të marrin pjesë në shfaqjet e vetme kulturore në QKR, QKI, KO-RA, MNT, Muzeu i Qytetit të Shkupit, Shtëpia e ARM, Stacioni i vogël, Biblioteka „Vëllezërit Miladinov“, si dhe në lokacione të tjera nëpër të gjithë qytetin.

Shoqërimin kulturor gjatë gjithë natës e pasurojnë shfaqjet e fëmijëve nga „Bilbili i artë“ në Kopshtin zoologjik, shfaqjet në sheshin para Sallës universale, si dhe Show për fëmijë në Qendrën kulturore për fëmijë „Karposh“. Në bashkëpunim me Lidhjen e sporteve të Shkupit dhe Federatës së basketbollit të Maqedonisë, u mbajt gara e basketbollit Streetball, turne klasik sipas sistemit nokaut, ndërmjet ekipeve të përziera të basketbollit nga shkollat e mesme të qytetit të Shkupit.

## GALERIA „JUSTINA DHE RODOLJUB ANASTASOV“



Piktori akademik Rodoljub Anastasov nënshkroi Kontratë me Muzeun e qytetit të Shkupit për donacionin e 389 veprave me nënshkrimin e doajenit të artit figurativ bashkëkohor maqedonas, që do të mbeten në pronësi të përhershme të MQSH. Përmbledhja e veprave të cilën e dhuroi piktori akademik Anastasov përbëhet nga vizatime, pastel, akualet dhe vepra të punuara me teknikë të kombinuar vaj në pëlthurë, në periudhën nga viti 1957 deri në vitin 2010.

Me rastin e donacionit të Rodoljub Anastasov, Muzeu në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit dhe Ministrinë e kulturës të Republikës së Maqedonisë, mundësuan përkrahje materiale për hapjen e galerisë e cila do të mbajë emrin e donatorit dhe të bashkëshortes së tij - Galeria „Justina dhe Rodoljub Anastasov“.

## KOLONI NDËRKOMBËTARE E ARTEVE FIGURATIVE „SHKUPË“

Në hotelin „Arka“, në qendrën e Çarshisë së vjetër të Shkupit, çdo vit mbahet Kolonia ndërkombëtare e arteve figurative „Shkupit“. Pjesëmarrësit e kolonisë tradicionalisht krijojnë në temën „Shkupit“, kurse një pjesë e tyre janë piktorë nga qytetet e vëllazëruara të Shkupit dhe qytete me të cilat Qyteti i Shkupit në të kaluarën ka vendosur bashkëpunim kulturor. Në koloni deri tani kanë marrë pjesë piktorë nga Turqia, Franca, Mali i Zi, Sllovenia, Kroacia, Serbia, Armenia, Shqipëria dhe nga vende të tjera.

Pas përfundimit të kolonisë u botua katalog dhe u organizua ekspozitë me vepra nga kolonia, Ditën e çlirimit të Shkupit - 13 Nëntori. Sponsor i kolonisë është Qyteti i Shkupit, organizimi teknik është i Muzeut të qytetit të Shkupit në partneritet me hotelin „Arka“, i cili është sponsor kryesor i kolonisë.



## MË SHUMË SE TRIDHJETË VERA „VERA E SHKUPIT“



Ajo që përshkruan „Vera e Shkupit“ janë epitete për manifestimin kulturor më voluminoz, më të shumëllojshëm, më afatgjatë dhe sipas vlerësimeve kompetente një nga manifestimet kulturore ndërkombëtare më me kualitet që mbahen në Republikën e Maqedonisë. Vërtetim për renomenë e vetë manifestimi siguron edhe jashtë kufijve të Maqedonisë të verifikuar me anëtarësimin në Asociacionin ndërkombëtar të festivaleve dhe asociacioneve – IFEA.

Manifestimi përfshin koncerte muzikore, opera, shfaqje baleti dhe dramatike, ekspozita pikturash dhe fotografish, program filmik, performansa dhe projekte multimediale, së bashku me produksionin e vetë të projekteve dhe shfaqjeve të shumta nga jashtë vendit.

Çdo vit fillon nga data 21 qershor, dita e parë e verës dhe „Dita botërore e muzikës“ ngrihen perdet e tridhjetë lokaliteteve të ndryshme – skena, të Verës së Shkupit. Deri më 31 korrik, kur përfundon manifestimi, në ritmin e natyrës shpirtërore pulsojnë skenat e hapura të verës së Shkupit në Kalanë e Shkupit, Çarshinë e vjetër, Kurshumli an, Suli an, Bregun e lumit Vardar, Parkun e qytetit, sallonet e teatrove dhe galerive të artit.



## 20 VJET „VALLE PA KUFIJ“



Qendra kulturore rinore „Karposh“ çdo vit organizon Festivalin folklorik ndërkombëtar për fëmijë „VALLE PA KUFIJ“, eveniment që në vazhdimësi krijon miqësi të reja dhe i afron fëmijët nga e gjithë bota. Ky festival, i cili është festivali më masiv dhe më i vjetër në vend, vitin e kaluar festoi jubileun e 20-të të tij, kurse

qyteti i Shkupit dhe Republika e Maqedonisë ishin nikoqirë të mijëra mysafirëve të huaj dhe nga vendi – valltarë.

Në suazat e programit të festivalit, tradicionalisht mbahet defile folklorike nëpër qendrën e qytetit deri tek Ura e gurit, ku mbahet hapja solemne e festivalit. Pjesëmarrës në „VALLE PA KUFIJ“,

në dekadat e kaluara ishin valltarë nga Polonia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Turqia, si dhe nga shumë ansamble vendase.

## „NGJYRAT E VITIT TË RI TË SHKUPIT“



Në manifestimin tradicional „Ngjyrat e Vitit të Ri të Shkupit“ Qyteti i Shkupit jep shpërblime për oborret e zbukuruara më mirë të shtëpive individuale, tarracat e banesave, objektet afariste dhe oborret e shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit. Qëllimi i këtij manifestimi është që të nxiten qytetarët të kontribuojnë për pasurimin e ambientit të Vitit të Ri në qytet.

Byroja për turizëm dhe informacione e Qytetit të Shkupit në bashkëpunim me QKF „Karposh“ filloi projektin „Roja turistike“ i cili është i destinuar për promovimin e territorit qendror të qytetit para turistëve që vizitojnë qytetin tonë. Prezantuesit të veshur me veshje kombëtare maqedonase, karakteristike për periudha kohore të caktuara, të interesuarve ua promovojnë monumetet kulturore historike në qendrën e qytetit.



# EDICIONI I PARË „SHKUPI KREATIVA“ 2012



mbajt në pjesën e parë të Parkut të qytetit, nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit. Festivali është pjesë e projektit për zhvillimin e industrive kreative qëllimi themelor i të cilave është promovimi i potencialit krijues nëpërmjet zhvillimit të industrive kreative si faktor për zhvillimin ekonomik të Shkupit, në arkitekturë, dizajn, teknologji informatike, arte vizuale, produksione TV, video lojëra, modë etj.

Festivali filloi me hapjen e Konferencës së parë ndërkombëtare „Industri kreative-teori e shndërruar në praktikë“. Çmimin për zgjidhjen ideore më të mirë për logon e festivalit „SHKUPI KREATIVA“ e mori studentja e Universitetit evropian Kristina Georgievska.

Tridhjetë pjesëmarrës, krijues nga fusha e teknologjisë TI, dizajnit të modës, filmit, teatrit, muzikës dhe letërsisë ishin pjesë

e programit të pasur në edicionin e parë të festivalit për industri kreative „SHKUPI KREATIVA“, që nga data 14 deri më 16 qershor u

## FESTA E BLIRËVE

Në shoqatën e shkrimtarëve të Maqedonisë, me pjesëmarrjen e shumë poetëve dhe mysafirëve, çdo vit mbahet Manifestimi ndërkombëtar i poezisë „Festa e blirëve“. Në manifestim, një shkrimtari të huaj dhe një shkrimtari maqedonas u ndahen çmimet „Skeptri i letërsisë“. Kryetari i Qytetit të Shkupit, laureatin e huaj, e shpall qytetar nderi të Shkupit. Qyteti i Shkupit është sponsor tradicional i këtij manifestimi.

## MUZIKANTË TË RRUGËS ZBAVITËN QYTETARËT E SHKUPIT

Muzikantë, grupe muzikore, zhonglerë, pantonimistë, magjistare dhe amatorë të tjerë ose artistë profesional zbavitën qytetarët e Shkupit në dhjetë lokacione në qendrën e qytetit. Angazhimi i muzikantëve të zgjedhur është i përditshëm, nga ora 11 deri në orën 14 dhe nga ora 17 deri në orën 20, kurse me ta është nënshkruar kontratë për përcaktimin e kompensimit mujor në të holla, në nivel vjetor.

Sponsor i projektit për muzikantët e rrugës, që organizohet tashmë dy vjet është Qyteti i Shkupit, kurse e realizon IP QOM „Salla universale“ Shkup.





# KAFJALL NË URË

Dy mijë qytetarë edhe këtë vjeshtë kishin mundësi drekojnë së bashku në Urën e gurit dhe të shoqërohen si pjesë e manifestimit „Kafjall në urë“. Sponsor i këtij evenimenti është kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, kurse si partnerë janë përfshirë anëtarët e Dhomës ekonomike të Qytetit të Shkupit dhe shkolla e hotelerisë SHMQSH „Llazar Tanev“.

Hyrja për pjesëmarrje në këtë manifestim është falas, por vetëm me bileta hyrëse të siguruar më parë për të cilat qytetarët e Shkupit çdo vit paraqiten në punktin special të vendosur në sheshin „Maqedonia“.



Me organizimin e manifestimit „Kafjall në urë“ Qyteti i Shkupit do që t'i bashkojë dhe afrojë të gjithë qytetarët e Shkupit, t'i

nxisë dhe t'i respektojnë vlerat tradicionale të veta.

## „DITËT E ARTIZANATIT“ NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Në Çarshinë e vjetër të Shkupit, para Shtëpisë së artizanatit, çdo vit mbahet manifestimi „Ditët e artizanatit“ në suazat e të cilit mbahet edhe festivali i artizanatit. Ky manifestim është vetëm pjesë e aktiviteteve me të cilat Dhoma ekonomike përfshihet në projektin për gjallërimin e Çarshisë së vjetër të Shkupit.

Manifestimi „Ditët e artizanatit“ u mbajt në disa qytete në vendin tonë, Shkup, Kumanovë, Shtip, Veles, Resnjë, Manastir, Tetovë, Gostivar, Prilep dhe Strumicë. „Ditët e artizanatit“ është nën organizimin e Dhomës ekonomike të Republikës së Maqedonisë dhe anëtarëve të saj, Ministrisë së ekonomisë dhe komunave.



## BASKERFEST

Në disa lokacione nëpër Shkup, çdo vit nën qiell të hapur mbahet Festivali ndërkombëtar „Baskerfest“. Gjatë kohës së mbajtjes së këtij festivali, Shkupi u transformua në një teatër rrugë madhështor, kurse Shkupjanët i zbavitnin mbi 70 artistë, me rreth 25 shfaqje të ndryshme muzikore, zhonglerë dhe akrobatë. Artistët vijnë nga vende të ndryshme dhe në një mënyrë të veçantë na sjellin dijet dhe eksperiencën e vet, duke shprehur shkathtësitë dhe talentin e tyre.

Sponsor i „Baskerfest“ është Qyteti i Shkupit, kurse organizator është OJQ „ONE WAY“.

## FESTIVALI I BIRRËS NË SHKUP

Fundjava e lakmuesit me birrë „Pivolend“ çdo vit tërheq mijëra vizitorë, adhurues të birrës, ushqimit të mirë dhe muzikës së mirë. Vitet e kaluara, lokacioni në të cilin u zhvillua zbavitja pesëditore „Pivolend“ është parkingu para Qendrës sportive „Boris Trajkovski“, i cili është pajisur në mënyrë speciale për këtë eveniment, kurse hyrja është falas për të gjithë vizitorët.

Që fundjava e lakmuesit me birrë është një shoqërim i shkëlqyer muzikor, gastronomik-birre, e tregoi edhe „Pivolend 2012“.



## FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I VERËS „VINO-SKOP“



Çdo vit në tetor në sheshin „Maqedonia“ mbahet Festivali ndërkombëtar për promocionin e verës „Vino-Skop“. Në suazat e këtij festivali, me prodhimet e tyre të verës u prezantuan mbi 30 kantina vere nga vendi dhe të huaja, kurse më shumë se pesëdhjetë mijë vizitorë të „Vino-Skop“ kënaqen me specialitetet e ndryshme gastronomike dhe degustojnë lloje të ndryshme të verërave nga prodhuesit.

Festivali ndërkombëtar për promocionin e verës „Vino-Skop“ është i sponsorizuar nga Qyteti të Shkupit.

## NË SHKUP U VENDOSËN 17 PANO MODERNE TURISTIKE

Qyteti i Shkupit vendosi 17 reklama të dyanshme, me 34 harta tredimensionale turistike në të cilat janë paraqitur vendet më të rëndësishme në qytetin tonë. Hartat janë në tre gjuhë (maqedonisht, shqip dhe anglisht) dhe përmbajnë pamje të regjionit dhe legjendë me informacione për institucionet e rëndësishme dhe monumente të tjera të rëndësishme për qytetin e Shkupit.

Bilbordet janë vendosur në lokacione të ndryshme në territorin e qendrës së qytetit





## SHTËPIZA PËR SHITJEN E LIBRAVE



Në bregun e lumit Vardar në qendrën e Shkupit, përballë stacionit të vjetër të autobusëve „Drvodekor“, janë vendosur 9 shtëpiza për shitjen e librave dhe publikime të tjera gjë me të cilën Qyteti i Shkupit u siguroi kushte për punë shitëse të librave. Me shtëpizat menaxhojnë 9 persona fizikë, shfrytëzuesit e shtëpizave paguajnë kompensim mujor në vlerë 500 denarë, kurse kontrata për shfrytëzim me ta është nënshkruar për periudhë një vjeçare.

Për realizimin e këtij projekti nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, u ndanë rreth 4,5 milion denarë.

## PESË TEZGA TË REJA PËR SUVENIR

Qyteti i Shkupit promovoi tezgat e reja për shitjen e suvenirëve dhe të prodhimeve ushqimore që u vendosën në 5 lokacione në qendër të qytetit – para “City Galery”, para restorantit „Pelister”, para kafenesë „Trend”, tek pllaka-përkujtimore e Nënë Terezës dhe para Shtëpisë së ARM. Me tezgat e reja është unifikuar pamja e tezgave për shitjen e suvenirëve dhe prodhimeve ushqimore në qendër.

Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi rreth 1,4 milion denarë.



## 11 TEZGA PËR LIBRA DHE PUBLIKIME TË BOTUARA

Njëmbëdhjetë tezgat stilistike të unifikuara për shitjen e librave dhe publikimeve të botuara janë vendosur në sheshin „Maqedonia“ dhe në rrugën „Maqedonia“, me qëllim që të pasurohen përmbajtjet në vendet më të frekuentuara në qendrën e qytetit, por edhe që titujt më të rinj letrar të jenë të arritshëm nga qytetarët e Shkupit.





